



500 Heronj Shqiptarë në Shërbim të Sigurisë Ndërkombëtare



» faqe 3



ANIJA 'LISSUS' DHE EKIUPAZHI I SAJ NISEN NGA SARANDA DREJT OPERACIONIT 'SEA GUARDIAN', PAS NJË HISTORIE SUKSESI ME DHJETËRA OPERACIONE SHPËTIMI

Forcat e Armatosura të Shqipërisë vijojnë të mbajnë me profesionalizëm dhe përkushtim peshën e përgjegjësisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, duke kontribuar në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Nga baza detare e Sarandës, anija "Lissus" me 22 detarë në bord është nisur drejt Detit Egje, ku për një periudhë 6-mujore do të...

» faqe 3



HERONJTË ME UNIFORMË TË KUQE

Rrëfimi i zjarrfikësit Olsi Ziso, i cili prej 7 vitesh sfidon flakët dhe rrezikun për të shpëtuar jetë. Një histori guximi, sakrifice dhe krenarie shqiptare

Në oborrin e Qendrës së Zjarrfikëses në Maliq, era sjell ende një aromë të rëndë tymi. Është ora 9 e mëngjesit, por sytë e djemve të rinj duken të lodhur sikur nuk kanë fjetur prej ditësh. Përballë nesh qëndron Olsi Ziso, një 28-vjeçar nga Korça, që prej shtatë vitesh jetën ia ka kushtuar flakës,...

» faqe 6



HISTORIA TAKOHET ME TË ARDHMEN: KOMPLEKSI MUZEAL I FA-SË NË BËRZHITË MERR JETË TË RE

Kompleksit Muzeal të Forcave të Armatosura në Bërzhitë do t'i shtohen së shpejti hapësira moderne, të cilat do të lidhin historinë me komunitetin, të shkuarën me të ardhmen. Në projektin e hartuar nga studioja prestigjioze arkitekturore "Bofill Taller de Arquitectura", kompleksi muzeal konceptohet si një rrëfim i gjallë arkitektonik, që sjell më pranë qytetarit jo vetëm një muze, por edhe një hapësirë të përbashkët për kujtesë...

» faqe 2

Historia takohet me të ardhmen: Kompleksi Muzeal i FA-së në Bërzhitë merr jetë të re

Kompleksit Muzeal të Forcave të Armatosura në Bërzhitë do t'i shtohen së shpejti hapësira moderne, të cilat do të lidhin historinë me komunitetin, të shkuarën me të ardhmen.

Në projektin e hartuar nga studioja prestigjioze arkitekturore “Bofill Taller de Arquitectura”, kompleksi muzeal konceptohet si një rrëfim i gjallë arkitektonik, që sjell më pranë qytetarit jo vetëm një muze, por edhe një hapësirë të përbashkët për kujtesë, identitet dhe bashkëjetesë.

Duke respektuar ndërtesat ekzistuese dhe natyrën përreth, projekti parashikon shtimin e godinave të reja dhe hapësirave funksionale, të cilat do të shërbejnë si për aktivitetet muzeale, ashtu edhe për nevojat e përditshme të Forcave të Armatosura dhe industrisë së mbrojtjes.

Ky zhvillim i rëndësishëm synon të forcojë jo vetëm kujtesën historike dhe identitetin kombëtar, por edhe marrëdhënien e ushtrisë me komunitetin.



Xhenierët shqiptarë në stërvitje shumëkombëshe në Letoni

Xhenierë nga Shqipëria, së bashku me kolegët e tyre nga Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Franca, Italia dhe Spanja, po zhvillojnë aftësitë e tyre gjatë një stërvitjeje të përbashkët në Letoni.

Stërvitja ka në fokus teknikat e shpërthimeve taktike për hapjen e rrugëve, ndërtimin e pengesave dhe pastrimin e minave, duke rritur ndërveprueshmërinë dhe aftësitë operacionale të forcave pjesëmarrëse. Ky aktivitet është një tjetër dëshmi e kontributit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në kuadër të aleancës dhe angazhimeve shumëkombëshe për sigurinë dhe stabilitetin e përbashkët.



500 Heronj Shqiptarë në Shërbim të Sigurisë Ndërkombëtare

Ushtarakët e Batalionit të Parë të Regjimentit të Këmbësonisë së Veriut, pjesë e Kontingjentit të VI, po kryejnë me përkushtim dhe profesionalizëm detyrat e tyre në kuadër të bashkëpunimit me aleatët e NATO-s.

Aktualisht, mbi 500 ushtarakë shqiptarë janë të angazhuar në misione ndërkombëtare të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara, duke dhënë një kontribut të çmuar për paqen dhe sigurinë globale.

Me praninë e tyre në Evropë, Afrikë dhe Lindjen e Mesme, Forcat e Armatosura të Shqipërisë dëshmojnë angazhim të palëkundur ndaj aleancave dhe partneriteteve strategjike, duke forcuar rolin e vendit tonë në sigurinë ndërkombëtare.



Komandanti i Komandës së Bashkuar Operacionale të Emirateve të Bashkuara Arabe viziton Bazën Ajrore të Kuçovës

Në Bazën Ajrore të Kuçovës u prit me nder Komandanti i Komandës së Bashkuar Operacionale të Emirateve të Bashkuara Arabe, gjeneralmajor Awad Saeed Al-Ahbabi. Vizita e tij shënoi një moment të rëndësishëm në forcimin e partneritetit mes Forcës Ajrore Shqiptare dhe asaj të Emirateve, duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm dhe kontributin e përbashkët në operacionet për menaxhimin e emergjencave dhe shuarjen e zjarreve.

Gjatë takimit u diskutuan praktikat më të mira për trajnimet dhe koordinimin ndërkombëtar, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit në situata emergjente dhe sfida të përbashkëta për sigurinë rajonale. Kjo vizitë është një tjetër hap i rëndësishëm drejt forcimit të marrëdhënieve strategjike dhe zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta operacionale mes dy forcave ajrore.



Efektivë të Policisë Ushtarake shqiptare në misionin “MFO”, Sinai

Tre efektivë të Policisë Ushtarake do të shërbejnë në përbërje të Forcës Shumëkombëshe të Vëzhgimit “Multinational Force and Observers – MFO” në Sinai, Egjipt.

Ky angazhim përbën një tjetër dëshmi të profesionalizmit, përgatitjes dhe besimit që gëzojnë Forcat e Armatosura të Shqipërisë në nivel ndërkombëtar, duke kontribuar në ruajtjen e paqes dhe sigurisë globale.

Pjesëmarrja në këtë mision konfirmon rolin e rëndësishëm të Shqipërisë si vend kontribuues në operacionet dhe misionet ndërkombëtare, si dhe përkushtimin e saj përkrah aleatëve dhe partnerëve strategjikë.





Anija 'Lissus' dhe ekuipazhi i saj nisen nga Saranda drejt operacionit 'Sea Guardian', pas një historie suksesi me dhjetëra operacione shpëtimi


Forcat e Armatosura të Shqipërisë vijojnë të mbajnë me profesionalizëm dhe përkushtim peshën e përgjegjësisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, duke kontribuar në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare.

Nga baza detare e Sarandës, anija "Lissus" me 22 detarë në bord është nisur drejt Detit Egje, ku për një periudhë 6-mujore do të shërbejë në kuadër të operacionit të NATO-s "Sea Guardian". Ky mision ka për qëllim rritjen e sigurisë detare në Mesdhe dhe parandalimin e kërcënimeve të ndryshme në hapësirat ujore.

Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes vizitoi ekuipazhin shqiptar, duke përcjellë urimet për një mision të suksesshëm dhe duke vlerësuar profesionalizmin e trupës detare, të udhëhequr nga kapiteni Jetnor Balla.

Vetëm gjatë këtij viti, ekuipazhet shqiptare kanë kryer 5 operacione të suksesshme në Egje, duke shpëtuar mbi 120 jetë. Në total, misionet e Forcave të Armatosura shqiptare në këtë zonë kanë realizuar 29 operacione shpëtimi, duke shpëtuar mbi 700 persona në det.

Nisja e "Lissus" shënon një tjetër dëshmi të angazhimit të Shqipërisë në misionet ndërkombëtare dhe të kontributit të saj të çmuar në Aleancë.



Heronjtë e qiellit, Forca Ajrore shqiptare në Ditën Ndërkombëtare të Helikopterëve

Çdo vit, më 19 gusht, bota shënon Ditën Ndërkombëtare të Helikopterëve, një datë që nderon kontributin jetik të këtyre mjeteve fluturuese dhe mbi të gjitha, guximin e pilotëve e teknikëve që i drejtojnë ato në shërbim të njerëzve.

Për Shqipërinë, kjo ditë është një mundësi për të vlerësuar "heronjtë e qiellit", pilotët, teknikët dhe gjithë trupën e Forcës Ajrore, të cilët janë gjithmonë në gatishmëri për të përballuar çdo sfidë. Në emergjencat natyrore, në shpëtimin e jetëve njerëzore, në transportin e ndihmave, në shuarjen e zjarreve apo edhe në operacionet ushtarake, helikopterët tanë janë shndërruar në një simbol shprese dhe sigurie.

Javët e fundit kanë qenë një dëshmi e qartë e këtij përkushtimi. Me fluturime të pandërprera në terrene të vështira dhe mes kushteve ekstreme, helikopterët e Forcës Ajrore



kanë dhënë një ndihmë të pazëvendësueshme në përballimin e zjarreve masive dhe menaxhimin e situatave emergjente. Çdo ngritje në ajër është një akt profesionalizmi, guximi dhe përgjegjësie ndaj jetëve dhe pasurisë së qytetarëve.

Krahas misioneve brenda vendit, Forca Ajrore shqiptare është gjithashtu një pjesë aktive e angazhimeve ndërkombëtare, duke treguar se pilotët dhe helikopterët tanë janë në nivel të barabartë me aleatët dhe partnerët në NATO. Ky angazhim dëshmon seriozitetin dhe profesionalizmin e FA-ve, të cilët përfaqësojnë me dinjitet flamurin kuqezi në çdo hapësirë ajrore ku shërbejnë.

Në këtë ditë simbolike, kombi shqiptar i shpreh mirënjohje heronjve të qiellit – atyre që me përkushtim, sakrificë dhe guxim mbrojnë jetën, natyrën dhe sigurinë e vendit.

Lavdi punës dhe misionit tuaj, Heronj të Qiellit!

Ushtria Shqiptare, historia me gjurmë të arta



Ka ndodhur më 15 gusht 1943 - krijohet Br.IS.
1945 - krijohet Marina Ushtarake Kombëtare.
Pas vitit 1958 u quajt Flota Luftarake Detare.



Më 8 gusht 1945, doli urdhri për krijimin e Artilerisë Bregdetare në
përbërje të komandës së artilerisë së ushtrisë.
Bateria Shkafane (Gjiri i Lalëzit) dhe simboli i ABD te balli i tunelit të
topit model 130 mm SM 4-1.



8 gusht 1943 - Në BRSS u miratua hyrja në shërbim e obuzit 152 mm D-1 M-1943.
Foto nga artileria jonë (Elbasan) e dërguar nga Kozma Borova.

8 gusht 1946, vendoset në pozicione
zjarri bateria e ABD në veri të Ishullit
të Sazanit.
Pasi shkarkoheshin në breg, transporti
bëhej me krahë deri te pozicionet.
Nga kujtimet e artiljerëve Sherbet Karuli
dhe Jaho Serjani jepet vetëm kalibri 105
mm gjerman (armë trofe).
Duke mos ditur saktësisht modelin, po
jap tre versionet e obuzit gjerman sipas
emërimit origjinal:
10.5 cm leFH18
10.5 cm leFH18/40
10.5 cm leFH18M
Në artilerinë mbretërore ka qenë dhe
obuzi italian 105/28.
(model francez Schneider 105 mm i
prodhuar nga Ansaldo & C në Genova)





INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në oborrin e Qendrës së Zjarrfikëses në Maliq, era sjell ende një aromë të rëndë tymi. Është ora 9 e mëngjesit, por sytë e djemve të rinj duken të lodhur sikur nuk kanë fjetur prej ditësh. Përballë nesh qëndron Olsi Ziso, një 28-vjeçar nga Korça, që prej shtatë vitesh jetën ia ka kushtuar flakës, jo për ta ndezur, por për ta shuar. Uniforma e kuqe duket e rëndë mbi shpatullat e tij, por kur fillon të tregojë, kupton se peshën më të madhe e mbart në shpirt.

Olsi, kthehemi pas në kohë. Si e kujton ditën e parë kur veshe këtë uniformë?

Ishte qershor i vitit 2018. Ishte vapë, ashtu si çdo fillim vere në Korçë. Kur më dhanë uniformën e kuqe, për një çast më dukej si një mantel i huaj. Por brenda meje ndjeva diçka që s’e kisha ndjerë më parë: një ndjesi se jeta ime nuk do të ishte më e imja, por e njerëzve që do të ndihmoja. Atë ditë vendosa se nuk do të tërhiqesha, sado e vështirë të bëhej.

Për shumë të rinj, ky profesion duket tepër i rrezikshëm. Çfarë të shtyu të hyje në këtë rrugë?

Unë jam rritur në një mjedis ku ndihma për tjetrin është vlerë. Korça është qytet solidar. Kam parë gjithmonë njerëz që sakrifikojnë për njëri-tjetrin. Kur pashë mundësinë të hyja në Zjarrfikëse, ndjeva se ishte thirrja ime. Nuk më tërhoqi ideja e rrezikut, por e mundësisë për të qenë dikush që shpëton jetë.

Ne e ndjekim Olsin ndërsa hyn në garazhin ku qëndrojnë mjetet. Me dorën mbi një makinë të vjetër zjarrfikëse, ai buzëqesh me trishtim: “Kjo makinë ka parë më shumë flakë se sa shumë prej nesh. Ka qenë në operacione ku gomat e saj digjeshin nga nxehtësia e terrenit”.

Çfarë ndodh kur bie alarmi? Si duket ai moment?

Është një sekondë që të ndryshon gjithçka. Mund të jesh duke ngrënë bukë, duke folur me një shok, apo edhe duke qeshur. Dhe papritur, sirena të bën të ngrihesh menjëherë në këmbë. Zemra të rreh fort, gjaku të vlon. Nuk di se çfarë të pret, vetëm vrapon, hipën në mjet, dhe e di që mund të jetë dita më e rëndë, ose më e bukura, nëse ia del të shpëtosh dikë.

Na trego një nga momentet më të vështira që nuk do ta harrosh kurrë.

Një nga ato momente ishte në fshatin Strelcë, në një pyll të madh me pisha. Zjarri përhapej me shpejtësi të frikshme. Terreni ishte aq i thyer, sa mjetet nuk mund të hynin. Ne ecnim në këmbë, me bidonë e pompa shpine. Tym, nxehtësi, frikë. Për një çast flaka u afrua aq shumë sa mendova: “Këtu mund të mbetem.” Por shokët nuk dorëzoheshin. Njëri thërriste tjetrin, jepnim zemër me zë. Ajo ditë na mësoi se forca e grupit është më e madhe se çdo flakë.

Ju keni qenë edhe në operacione jashtë Shqipërisë, në Greqi. Çfarë kujtimesh të kanë mbetur nga ajo situatë tepër

Heronjtë me uniformë të kuqe

Rrëfimi i zjarrfikësit Olsi Ziso, i cili prej 7 vitesh sfidon flakët dhe rrezikun për të shpëtuar jetë. Një histori guximi, sakrifice dhe krenarie shqiptare



“KËTO DITË NUK JANË TË LEHTA, AS PËR SHQIPËRINË, AS PËR EUROPËN. FLAKËT NUK NJOHIN KUFIJ, NUK BËJNË DALLIM MES SHTËPISË SË NJË TË VARFRI APO TË NJË TË PASURI, MES PYLLIT TË NJË FSHATI APO MALIT TË NJË SHTETI TJETËR. ÇDO ZJARR ËSHTË NJË PLAGË QË PREK TË GJITHË SHOQËRINË. PRANDAJ MESAZHI IM ËSHTË I QARTË: TË GJITHË DUHET TË BËHEMI MË TË PËRGJEGJSHËM. SHUMË PREJ KËTYRE ZJARREVE NUK I SJELL NATYRA, POR DORA E NJERIUT NGA PAKUJDESIA, NGA PAPËRGJEGJËSIA, MADJE EDHE NGA DASHAKEQËSIA.

e vështirë?

Në Aleksandropol, 15 ditë pa pushim. Zjarri nuk njihte kufij. Punonim krah për krah me zjarrfikës grekë. Ata kishin mjete më të shumta, por ne kishim guximin dhe përkushtimin. Por kur sheh se një banor të falënderon me lot në sy, nuk ka rëndësi nëse kishe cisternë 20 mijë litra apo vetëm një pompë të vogël.

Në zyrë, mbi tavolinë, Olsi mban një fotografi të ekipit gjatë operacionit në Greqi. Flakët ndriçojnë qiellin, fytyrat e djersitura duken të lodhura, por sytë shkëlqejnë nga krenaria.

Në Shqipëri shpesh përballeni edhe me banorë që nuk duan të largohen nga banesat e tyre edhe pse iu rrezikohet jeta. Si ia dilni?

Ky është momenti më i dhimbshëm. Ata e shohin shtëpinë si



gjithë jetën e tyre. Në Gramsh, një i moshuar u shtrëngua pas derës dhe tha: “Po iku kjo shtëpi, iku gjithë jeta ime”. Lotët më rridhnin ndërsa e bindja. Dhe e mora prej krahu. I thashë: “Xhaxha, jeta jote vlen më shumë se çdo gur”. Dhe sot jam i lumtur që e shpëtua. Sepse shtëpinë mund ta ndërtohen sërish, por jetën jo.

Po frika? A ka vend për të?

Frika është gjithmonë aty. Do të gënjeja po të thosha ndryshe. Por mbi frikën qëndron përgjegjësia. Kur sheh kolegun tënd të futet në flakë, edhe ti futesh. Kur e di se aty brenda ka jetë njerëzish,

frika kthehet në forcë.

Çfarë ju mungon më shumë në këtë profesion?

Pajisjet. Ne kemi zemër, kemi vullnet, kemi forcë. Por shpesh mungojnë makineritë, cisternat e mëdha, mjetet për terrene të vështira. Shpesh na është dashur të ecim me orë të tëra në këmbë me peshë mbi shpinë, sepse rrugët nuk lejojnë mjetet.

Pas gjithë këtyre përvojave, çfarë ndjen sot kur sheh uniformën tënde?

Krenari. Po edhe përgjegjësi. Nuk është një punë që e bën për

rrogën. Është një betejë që e bën për shpirtin. Çdo ditë e di që mund të shkoj në shtëpi i lodhur, i tymosur, por i lumtur që një jetë është shpëtuar. Dhe kjo mjafton.

Olsi, cili është mesazhi juaj në këto ditë të vështira që po kalon vendi ynë por dhe gjithë Europa, ku flakët e zjarrit shkaktuar nga njerëz të papërgjegjshëm po përpijnë banesa, pyje dhe gjënë e gjallë?

“Këto ditë nuk janë të lehta, as për Shqipërinë, as për Europën. Flakët nuk njohin kufij, nuk bëjnë dallim mes shtëpisë së një të varfri apo të një të pasuri, mes pyllit të një fshati apo malit të një shteti tjetër. Çdo zjarr është një plagë që prek të gjithë shoqërinë. Prandaj mesazhi im është i qartë: të gjithë duhet të bëhemi më të përgjegjshëm. Shumë prej këtyre zjarreve nuk i sjell natyra, por dora e njeriut nga pakujdesia, nga papërgjegjësia, madje edhe nga dashakeqësia. Dhe kur një person ndez një zjarr, duhet të kuptojë se nuk djeg vetëm një shkurre apo një kasolle, por vë në rrezik jetë njerëzish, jetën e fëmijëve tanë, të kafshëve, të pyjeve që janë mushkëritë e vendit tonë. Si zjarrfikës, çdo ditë shoh se sa e brishtë është jeta. Një shkëndijë mjafton të shndërrojë gjithçka në hi. Por po aq mjafton edhe një gjest përgjegjësie që ta ndalojë atë shkëndijë. Prandaj thirrja ime është: mos u bëni indiferentë! Mos prisni që të vijë zjarrfikësi për të shpëtuar atë që mund të shmangej me kujdes. Të gjithë kemi një rol në këtë betejë. Dua t’u them qytetarëve: bashkëpunoni me ne, lajmëroni menjëherë, tregohuni vigjilentë. Dhe mbi të gjitha, mos e nënvlerësoni zjarrin. Sot më shumë se kurrë, është koha për solidaritet dhe ndërgjegjësim. Vetëm bashkë mund të mbrojmë shtëpitë tona, pyjet tona, jetën tonë. Sepse flakët janë të forta, por më i fortë është vullneti i njerëzve që bashkohen për të shpëtuar atë që kemi më të shtrenjtë.”

Intervista me Olsi Zison na kujton se heronjtë nuk janë vetëm në libra. Ata jetojnë mes nesh, shpesh pa u vënë re, nën një uniformë të kuqe që përfaqëson guximin, sakrificën dhe dashurinë për jetën. Në një kohë kur zjarret, përmbytjet dhe emergjencat po shtohen, zjarrfikësit shqiptarë mbeten një mur mbrojtës për qytetarët. Ata janë forca që e përballon flakën me vendosmëri dhe që shpesh vë jetën në rrezik për të shpëtuar jetën e dikujt tjetër.

Gazeta “Ushtria” u shpreh mirënjohjen më të thellë Olsit dhe çdo kolegu të tij, që çdo ditë, me pak mjete e shumë zemër, mbrojnë Shqipërinë.

Intervistë ekskluzive për gazetën “Ushtria”

“ UNË JAM RRRITUR NË NJË MJEDIS KU NDIHMA PËR TJETRIN ËSHTË VLERË. KORÇA ËSHTË QYTET SOLIDAR. KAM PARË GJITHMONË NJERËZ QË SAKRIFIKOJNË PËR NJËRI-TJETRIN. KUR PASHË MUNDËSINË TË HYJA NË ZJARRFIKËSE, NDJEVA SE ISHTE THIRRJA IME. NUK MË TËRHOQI IDEJA E RREZIKUT, POR E MUNDËSISË PËR TË QENË DIKUSH QË SHPËTON JETË.





Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Maliq Sadushi, gjenerali, historiani, mençuri e Labërisë

Në përkujtim, nderim dhe mirënjohje të luftëtarit të rreshtave partizane, ushtarakut madhor që la gjurmë të thella në ngritjen, forcimin dhe konsolidimin e sistemit të mbrojtjes shqiptare si dhe historianit që gdhendi historinë e fshatit Vajzë dhe shkroi epopetë e dëshmorëve të fshatit të tij, duke u lënë brezave një trashëgimi të papërsëritshme si amanet brezash për të ardhmen.

Vajza e historisë, mençurisë, patriotizmit, trimërisë dhe lavdisë Kur flasim për fshatin Vajzë rrëzë malit të Beunit, këtë emër të njohur dhe të shquar në historinë e Vlorës, Labërisë, Shqipërisë, është e pamundur ta përfshijmë në pak rreshta fshatin e vlerave të rralla dhe që ka nxjerrë personalitete të të gjitha fushave. Fshati Vajzë me një emër kaq të veçantë dhe unik mbarë shqiptar është ndër fshatrat labe me mjaft tradita, vlera, histori me rrënjë amantive, e spikatur në histori, por mbi të gjitha me njerëz që i kanë dhënë shumë fshatit, Vlorës historisë labe dhe që kanë vendosur edhe për fatet e zhvillimet e vendit në shumë fusha të zhvillimeve shqiptare. Ndër bijtë e saj të shquar zë vend dhe gjeneral Maliq Sadushi, krahas figurave të tilla si Ali Asllani, Sulejman Rexhepi, Perlat Rexhepi, Lavdosh Ahmetaj etj. Fshati Vajzë është vendlindja e legjendës së trimërisë vajziote Hito Zenel Hitaj (shpallur dëshmor më 11.4.2025), poetit kombëtar Ali Asllanit, e heroit dhe dëshmorit të epopesë së tre heronjve të Shkodrës Perlat Rexhepit, luftëtarit legjendë Gani Mystehaku-Vajza (Sulçaj), por edhe i dy ish-ministrave; Lavdosh Ahmetaj dhe Maliq Sadushit, që edhe pse ishte zëvendësministër i parë i Mbrojtjes, duke qenë se Mehmet Shehu ishte edhe kryeministër për shumë vite, kreu detyrën në një nivel me ministrat e tjerë në qeverinë shqiptare. Këtu në Vajzë gjen histori nga më të vjetrat e deri tek patriotizmi dhe atdhedashurinë e pashtershme, gjen epokat me njerëz të pushkës dhe të penës, që i kanë kaluar sinorët e fshatit Vajzë, të krahinës së Labërisë, por dhe më gjerë mbarë rrafshin kombëtar. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e gjen Maliq Sadushin ende të parritur me shpirt të zjarrtë që u lidh fuqishëm me formacionet e ilegaleve të parë partizanë. Djaloshi 13 vjeçar ishte ndër më të rinjtë e organizatës së rinisë antifashiste, duke qenë ndër të parët që u përfshi në radhët e saj. Në fillim të viteve 1942-1943 dhe në vijimësi lufta çlirimtare mori hov dhe Maliqin e gjejmë në formacionin e parë të çetës territoriale të Vajzës, në luftimet e Gjormit, e më tej pjesëmarrës në të gjitha luftimet. Në muajin korrik të vitit 1943, Maliq Sadushi rreshtohet si luftëtar në batalionin partizan "Ismail Qemali" të Vlorës dhe prej 28 Nëntorit 1943, me formimin e Brigadës së Pestë, në fshatin Gumenicë rreshtohet si partizan i thjeshtë dhe më pas komandant skuadre. Baza e Br.VS edhe pse kishte pesë batalione ishte batalioni "Halim Xhelu" dhe "Ismail Qemali" me një efektiv prej më se 500 vetash. Komandant i kësaj njësie ishte caktuar Abaz Shehu dhe komisar Hysni Kapo, ndërkohë që Maliqi ishte pjesëmarrës në gjithë veprimtarinë luftarake të kësaj brigade heroinë nga dita e inaugurimit më 20.1.1944 në Bramyshnjë të Tërbaçit me drejtuesit komandant Shefqet Peçi dhe komisar Hysni Kapo. Maliq Sadushi dhe të tjerë vajziotë të shumtë e pasuruan historikun e fshatit Vajzë dhe e ridimensionuan atë falë mençurisë, patriotizmit, trimërisë, punës, fisnikërisë, njeri tërësisht i vërtetë dhe i vlerave të larta njerëzore.

Jetë e ndershme në luftë dhe në punë e ushtarakut madhor Maliq Sadushi

Maliq Sadushi lindi më 2.2.1928 në Vajzë të Vlorës. Rrjedh nga një familje me tradita të shquara atdhetare dhe patriotike si nga babai edhe nga nëna. Babai i tij dhe gjyshi nga nëna kanë marrë pjesë në armë në dorë në Luftën e madhe të Vlorës më 1920. Jeta e Maliqit ka qenë tejet e vështirë, pasi në moshën 2 vjeç i vdiq nëna dhe në moshën 4 vjeç edhe babai. Kështu që Maliqi i vogël u rrit jetim. Pavarësisht vështirësive të mëdha kreu shkollën fillore në fshatin e lindjes në Vajzë të Vlorës. Më 1939 detyrohet të fillojë punë për të përballuar jetën, kur ishte vetëm 11 vjeç. Në vitin 1942 organizohet me grupin e të rinjve antifashistë të krahinës së Kudhësit. Rreshtohet partizan në çetën e Vajzës në moshën 14 vjeç, më pas në batalionin partizan "Ismail Qemali"; më tej jeta partizane e çoi në një prej formacioneve të mëdha dhe më të lavdishme të LANÇ-it, pasi në nëntor 1943 rreshtohet në Brigadën e 5-të Sulmuese dhe në dhjetor 1943 pranohet anëtar partie, sipas dokumentacionit dhe autobiografisë së tij. Maliqi i rreshtuar në radhët e Brigadës së 5-të sulmuese e ndoqi armikun deri përtej kufijve shtetërorë, në tokat shqiptare deri në Sanxhak të Jugosllavisë, duke kontribuar për çlirimin e shqiptarëve jashtë "Shqipërisë Londineze" dhe popujve të ish-Jugosllavisë. Lufta e burrëroi, trimëroi, mençuroi Maliqin, që e nisi luftën që fëmijë dhe në radhët e saj së bashku me moshatarët e tij. Në shtator 1944, emërohet zëvendës komisar kompanie. Lufta tashmë kishte marrë përmasa të mëdha në mbarë vendin, madje një pjesë e njësive luftarake në përbërje të dy divizioneve sulmuese kishin kaluar kufijtë administrativë të Shqipërisë, për t'u ardhur në ndihmë vëllezërve kosovarë në luftën kundër forcave gjermano-çetnike. Maliqi në këtë kohë ishte luftëtar i rreshtuar në Brigadën XXV Sulmuese të Divizionit të 5-të Sulmues, të Ushtrisë Partizane Shqiptare. Është për t'u evidentuar dhe theksuar, se Maliqi në të

Maliq Sadushi - Jeta dhe veprimtaria e një ushtaraku të ndershëm, nga pushka partizane tek drejtimi i ushtrisë shqiptare



gjitha luftimet ku mori pjesë u tregua i vendosur, luftarak dhe trim, me një aktivitet shumë domethënës luftarak, një prerje për ushtarak që gjatë luftës. Nga tregimet e bashkëmoshatarëve, por mbi të gjitha nga dokumentet që flasin qartë dhe bindshëm, gjejmë se "Maliqi ishte luftëtar që në luftën e Gjormit, më 31.12.1942 dhe 2.1.1943, luftën e Drashovicës, më 14.9.1943 deri më 5.10.1943, Operacioni gjerman i Qershorit 1944, në Skrapar e Gramsh, luftimet në rrethinat e Tiranës, në Mullet, në shkallën e Tujanit, në Zall-Herr nga fundi i muajit qershor - fillimi i muajit korrik 1944, luftimet e Kukësit në shtator 1944, lufta e Gjakovës si dhe luftimet e Sanxhakut në Jugosllavi në fundin e vitit 1944-1945. Veprimtaria e tij gjithëpërfshirëse bëri që ta njohë trimin e luftëtarin e fshatit Vajzë jo vetëm Labëria, por mbarë Shqipëria. Kur citon aktivitetin luftarak të Maliqit dhe shokëve të tij në luftë në lulen e rinisë, jo vetëm brenda kufijve të Shqipërisë por dhe jashtë saj deri në Jugosllavi, shohim qartë shprehjen e idealizmit luftarak, ndërgjegjen kombëtare, atdhetarizmin e vrullin rinor, që e shpërfillnin vdekjen në të gjitha ditët e luftës. Pas çlirimit të vendit rreshtohet në forcat e ndjekjes për asgjësimin e bandave diversioniste deri më 5 dhjetor 1945. Më pas caktohet shef i seksionit të sigurimit të ushtrisë pranë Komandës së Përgjithshme të UNÇSH-së. Pas një kursi njëvjeçar caktohet komandant batalioni në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Pastaj kryen kursin për filozofi dhe ekonomi politike prej vitit 1955-1956. Nga viti 1958-1961 kryen Studimet e Larta në Moskë në "Akademinë Ushtarake Frunxe". Në korrik 1962, emërohet komandant i Brigadës në Laç, e më pas Komandant i Brigadës së Këmbësorisë në Kukës. Prej 1968-1969 kryen Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Prej 1969-1973 caktohet shef shtabi Korpusi. Prej vitit 1973-1974 caktohet pedagog në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu". Prej vitit 1974-1982 ka kryer detyrën e Zëvendësministrit të Parë të Mbrojtjes Popullore dhe njëkohësisht deputet i Kuvendit Popullor për Vlorën dhe anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor. Në mes-tetorin e vitit 1982 shkarkohet nga të gjitha detyrat shtetërore dhe nxirret në lirim padrejtësisht për dyshime si pjesëtar i "Komplotit" të Mehmet Shehut e Kadri Hazbiut. Maliq Sadushi ishte vetëm 54 vjeç kur u nxor në lirim, një vit para se të mbushte moshën normale të daljes në pension, pasi ushtarakët pensionoheshin në atë periudhë në moshën 55-vjeçare.

Ushtarak me performancë dhe integritet të lartë intelektual

Pas përfundimit të LANÇ-it, Maliq Sadushi vijoi shërbimin në ushtri si oficer, me detyra të ndryshme si, komandant batalioni në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha", me studime të larta ushtarake në Akademinë Ushtarake "Frunze" në Moskë, në Brigadën e 5-të Këmbësorisë në Gjirokastrë, shef shtabi brigade në Vlorë, komandant brigade në Laç, shef shtabi Divizioni në Shkodër, shef shtabi korpusi përsëri në Shkodër, student dhe pedagog në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu". I goditur në vitin 1973, kur u shkarkua padrejtësisht nga detyra e shefit të shtabit të korpusit, i rivlerësuar dhe emëruar me plotë të drejtë zëvendësministër i Parë i Mbrojtjes, detyrë që e kreu deri sa Maliq Sadushin, më 15.10.1982, e zuri "Fshesa e dytë e hekurit" ndaj kuadrove të lartë të Ushtrisë Popullore. Por më saktë dhe qartësisht flasin urdhrat e emërimeve

dhe shkarkimeve, më qartë flet dokumentacioni shtetëror.

Në gjurmët arkivore të dokumentacionit për Gjeneralmajor Maliq Sadushin

Në të dhënat personale, në dosjen e ushtarakut madhor "Maliq Telo Sadushi" të datëlindjes 2.2.1928, nga fshati Vajzë, Sevaster, Vlorë, gjejmë të dhëna ekzakte: "Me urdhër të datës 1.5.1945, është emëruar me detyrë "Zëvendëskomandant kompanie", në Batalionin I, Brigada e 7-të Sulmuese, detyrë të cilën e ka kryer nga data 1.5.1945 deri më datë 1.3.1946. Me urdhër nr. 07-453, datë 09.3.1946, emëruar me detyrë "Komisar kompanie", në batalionin III, Regjimentin e 31-të, detyrë të cilën e ka kryer nga data 1.3.1946 deri më datë 1.12.1947. Më tej me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 07-2128, datë 28.5.1947, është titulluar oficer aktiv, marrëdhëniet financiare i kanë filluar më 1.12.1944. Me urdhër nr. 11-952 datë 1.12.1947, emëruar me detyrë "Instruktor rinie", në, Regjimentin e 31-të, detyrë të cilën e ka kryer nga data 1.12.1947 deri më datë 1.5.1948. Me urdhër nr. 11-571 datë 27.4.1948, është emëruar me detyrë "Shef seksioni sigurie", në Ministrit të Mbrojtjes detyrë të cilën e ka kryer nga data 1.5.1948 deri më datë 1.2.1949. Më tej me urdhër të datës 1.2.1949, ka qenë dëgjues në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve nga data 1.2.1949 deri më datë 1.12.1949. Me urdhër nr. 07-345, datë 10.1.1950, është emëruar me detyrë "Zëvendëskomandant kompanie", në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha", detyrë të cilën e ka kryer nga data 1.12.1949 deri më datë 1.12.1952. Me urdhër nr. 0685, datë 15.12.1952 është emëruar me detyrë "Shef stërvitje batalioni", në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, detyrë të cilën e ka kryer nga data 1.12.1952 deri më datë 4.1.1955. Me urdhër nr. 47, datë 4.1.1955 është emëruar me detyrë "Komandant batalioni special", në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, detyrë të cilën e ka kryer nga data 4.1.1955 deri më datë 30.4.1956. Me urdhër nr. 150, datë 10.4.1956 është emëruar me detyrë "Shef kuadri", në Repartin Ushtarak Nr.9357, detyrë të cilën e ka kryer nga data 30.4.1956 deri më datë 30.10.1956. Me urdhër nr. 560 datë 30.10.1956 është emëruar me detyrë "Komandant batalioni", Repartin Ushtarak Nr. 9357, detyrë të cilën e ka kryer nga data 30.10.1956 deri më datë 2.8.1958. Pas një sërë detyrash të suksesshme me urdhër nr. 0336, datë 3.8.1958 ka qenë me studime në Bashkim Sovjetik në Moskë në Akademinë Ushtarake "Frunxe" nga data 2.8.1958 deri më datë 16.5.1961; me urdhër nr. 0235, datë 17.5.1961 është emëruar me detyrë "Shef operativ", në Brigadën e 20-të, detyrë të cilën e ka kryer nga data 16.5.1961 deri më 28.7.1961; me urdhër nr. 0386, datë 28.09.1961, është emëruar me detyrë "Shef shtabi", në Brigadën e 20-të, detyrë të cilën e ka kryer nga data 28.7.1961 deri më datë 1.7.1963. Me urdhër nr. 0284, datë 4.7.1963 është emëruar me detyrë "Komandant Brigade", në Brigadën e 10-të, detyrë të cilën e ka kryer nga data 1.7.1963 deri më datë 21.3.1966; me urdhër nr. 0190, datë 29.3.1966, është emëruar me detyrë "Komandant Brigade", në Brigadën e 24-të, KM, Kukës, detyrë të cilën e ka kryer nga data 21.3.1966 deri më datë 1.9.1968; me urdhër nr. 1552, datë 2.9.1968, ka qenë dëgjues në Akademinë Ushtarake, nga data 1.9.1968 deri më datë 6.8.1969, në kursin e Shtabmadhorëve; më tej me urdhër nr. 0171,



datë 7.8.1969, është emëruar me detyrë “Shef shtabi”, në Korpusin e 9-të të Këmbësorisë, detyrë të cilën e ka kryer nga data 6.8.1969 deri më datë 5.11.1973; me urdhër nr. 0427, datë 5.11.1973, është emëruar me detyrë “Pedagog”, në Akademinë Ushtarake “Mehmet Shehu”, detyrë të cilën e ka kryer nga data 5.11.1973 deri më datë 11.12.1974; me urdhër nr. 110, datë 11.12.1974, është emëruar me detyrë “Zëvendësministër i Parë”, në Ministrin e Mbrojtjes, detyrë të cilën e ka kryer nga data 11.12.1974 deri më datë 15.10.1982; me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2967, datë 14.10.1982, ka dalë në rezervë dhe të drejtat financiare i janë ndërprerë më datë 15.10.1982, pas një karriere 37 vjeçare.

“Nëntoger” deri në “gjeneralmajor“, shërbëtor i devotshëm i shtetit

Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 07-2128, datë 28.5.1947 është titulluar oficer aktiv, i jepet grada “nëntoger”. Në vijimësi me urdhër nr. 07-2868, datë 14.5.1948 i jepet grada “toger”, me urdhër nr. 180, datë 18.4.1952 i jepet grada “kapiten II”, me urdhër nr. 252, datë 29.04.1955 i jepet grada “kapiten I”, me urdhër nr. 0167 datë 4.5.1959 i jepet grada “major”, me urdhër nr. 0207 datë 24.6.1963 i jepet grada “nënkolonel”, gradë që e ka mbajtur deri më datën 1 maj 1966. Nga viti 1966 deri më 15 tetor 1982, për 16 vite shërbimi ushtarak nëse do të ekuivalentonim funksionin Zëvendësministër i parë i MMP-së që i takon gradë madhore gjenerali, ndërkohë që UP-ja kishte një forcë aktive prej 61 mijë forcash ushtarake. Aktualisht gradat e ushtarakëve janë ekuivalentuar në përputhje me funksionin e kryer, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe me të drejtë; edhe pse për periudhën që nuk ka pasur grada në ushtri Maliq Sadushi vlerësohet me gradën madhore “gjeneralmajor”, për efekt të respektimit të historisë sonë ushtarake dhe kombëtare. Performanca intelektuale e Maliq Sadushit ishte nder për Vajzën e Labërinë, ishte krenari, kur shkëlqente në të gjitha shkollat dhe akademitë më prestigjioze të kohës, edhe në Moskë. Nderimi, respekti dhe mirënjohja është për detyrat e shumta me rëndësi e përgjegjësi të madhe në ngritjen e Ushtrisë Popullore. Në studimet e larta ushtarake nuk ishte thjesht një student, por hulumtues i thellë i artit ushtarak, një ushtarak me njohuri të spikatura teorike e profesionale, përfshi edhe Kursin e Lartë Operativ në Akademinë Ushtarake si Shtabmadhor, si profesionist i dijeve ushtarake. Maliq Sadushi u formua si oficer i lartë, me gjykim të thellë, me mendime të pjekura për artin ushtarak popullor, për teorinë dhe shkencën ushtarake në përgjithësi, duke u vlerësuar nga kolegët, eprorët dhe vartësit si pjesë e korpusit të të urtëve të Ushtrisë sonë Popullore, që e përmbushën misionin e tyre në kushtet nga më komplekse të kohës.

Burri që shkroi historinë me pushkë dhe me penë

Botimet që shkruhen nga pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në luftë, janë shumë të mirëpritur nga lexuesi, pasi nuk i kanë ngjarjet me të lexuar ose me të treguar, por nga jeta luftarake në luftën e përgjakshme për lirinë e Atdheut, si dhe në luftën e paepur për ngritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e një ushtrie tërësisht të re dhe të mbështetur fuqimisht në popull, që meritonte emërtimin “Ushtri Popullore”. Maliq Sadushi u spostua nga posti i lartë i komandimit dhe drejtimit strategjik në Ministri të Mbrojtjes si kuadër “puçist”, si kuadër i lartë që kishte punuar me Mehmet Shehun dhe Kadri Hazbiun. Por të vërtetat dhe realitetet në marrëdhëniet me detyrat i ka shprehur më shumë se një historian, duke sjellë ndershmërisht dhe pastërtisht realitetin ushtarak shqiptar dhe jo vetëm, sipas mendimit dhe mënyrës së tij të të shprehurit të qartë, të konkretizuar dhe të argumentuar. Ai ka shkruar disa libra sikurse janë: libri “Perlat Rexhepi”, kushtuar heroit dhe dëshmorit të fshatit Vajzë dhe mbarë kombit shqiptar, që shkroi epope trimërie në përleshje të përgjakshme me fashistët italianë në Shkodër. Libri i Maliq Sadushit për këtë hero është publikuar në vitin 2000. Më tej në moshë plotësisht të pjekur dhe të përmallur për vendlindjen publikoi librin “Fshati ynë i mirë”, në vitin 2002, që është një histori më vete e vendlindjes nga kohët amantike të lashtësisë ilire e deri në ditët tona, duke u ndalur veçanërisht në ngjarjet e mëdha të luftës antifashiste që i kishte përjetuar vetë nga radhët e çetës, batalionit, brigadës partizane e deri në majat e lidershipit në Ministrinë e Mbrojtjes. Duke qenë i armatosur me përvojën e jetës, me aftësinë dhe mençurinë për të shkruar dhe dokumentuar historinë, më 3.8.2004 publikon “Nga brigjet e Jonit në malet e Sanxhakut”, një përshkrim i jetës partizane, misionarët e të cilës e çuan Shqipërinë në anën e dhur të historisë, mes fitimtarëve, duke i dhënë statusin e fitimtarit të luftës dhe duke ia shtuar lavdinë kombit shqiptar. Në vitin 2005 botoi librin “Ata që nuk harrohen”, në të cilin pasqyroi biografinë historike të dëshmorëve të fshatit Vajzës, në dy luftërat më të mëdha, të Luftës së Vlorës të 1920 dhe të LANÇ-it. Në vitin 2008 shkroi një prej librave që historia do ta kërkojë gjithmonë “Mehmet Shehu, siç e kam njohur: kujtime”, publikuar në botimet “Almera”. Nga ana tjetër shkrimi i librit “Historiku i fshatit Vajzë” më 1981, është një ndër preokupimet madhore dhe një trashëgimi vitale e vendlindjes, një histori e të parëve e veçanërisht për historikun e shekullit XX të fshatit Vajzë. Aty gjejnë veten gjithë fiset e fshatit, 39 dëshmorët e vjetër dhe të rinj të fshatit Vajzë, ku meritë e parë e evidentimit të tyre është padyshim burri i zgjuar vajziot Maliq Sadushi. Ai nuk ia la rastësisë, por amanetin e brezave që bashkëfshatarët e tij të ekzekutuar me breshëri plumbash nga nazifashistët, e lanë testament të shkruar, një testament që u finalizua më 5 maj 2025 në fshatin Vajzë të Labërisë, ku erdhi vetë Ministri i Mbrojtjes, ai edhe kryetar i Komisionit qendror të statusit Dëshmor i Atdheut, për të nderuar gjakun e derdhur për liri. Ishin Maliq Sadushi dhe 17 bashkëfshatarë të tij që shkruan historinë e fshatit në vitet 70-të të shekullit të shkuar...dhe historia vijon dhe do vijojë në fshatin e traditës e atdhedashurisë.

Dëshmorët, amaneti i shkruar i antifashistit të orëve të para

Dëshmorët janë zemra e historisë sonë, e historisë vajziote, historisë labe dhe më gjerë e historisë mbarë shqiptare. Meraku për të rënë, për bashkëmoshatarët, për bashkëfshatarët dhe më gjerë sidomos për të ekzekutuarit nga nazifashistët ishin dhe

mbeti preokupimi i tij. Për këtë në librin e tij “Fshati ynë i mirë”, dedikuar fshatit të lindjes Vajzë, pasi i sjell përmbledhtas të gjitha ngjarjet historike e luftarake, por edhe biografitë e gjithë dëshmorëve të shpallur me vendime juridike, nuk harron edhe të ekzekutuarit me breshëri plumbash që janë një masakër që ende kullon gjak dhe dhimbje mbi një fshat të tërë. Maliq Sadushi në faqet e librit shprehet, dhe ne po e citojmë ekzaktësisht sipas faqes 271 dhe 272 të librit të tij “Fshati ynë i mirë” i vitit 2002: “Viktima të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Okupatori nazi-fashist në bashkëpunim me tradhtarët e vendit, në çdo operacion që ndërmori bëri terror në popull. Ata kapnin e pushkatonin gra e fëmijë të pafajshëm. Krime të tilla bënë edhe në Vajzë, duke kapur e pushkatuar pa gjyq nëntë vetë, midis tyre edhe dy gra. Po të merret parasysh aktiviteti i këtyre viktimave në dobi të luftës dhe mënyra se si janë kapur nga armiku, qëndresa e tyre etj., ata me të drejtë duhen quajtur dëshmorë të Luftës Nacionalçlirimtare e jo viktima. Ky problem mbetet i hapur edhe në organet kompetente dhe mund e duhet të shikohet në të ardhmen. Tani për tani, këta persona mbeten në kujtesën time si viktima të luftës, meqenëse ligjërisht ky problem nuk është zgjidhur ende”, një amanet që nuk e treste dheu. Të ekzekutuarit e meritojnë titullin dëshmor dhe i përmend me radhë: Ferik Zagoll Bilbilaj, Dalan Mehmet Kamberaj, Këze Shahin Sulçaj, Pesare Xhezo Kërroçaj, Beqir Hasko Osmanaj, Abdyl Hasko Osmanaj, Shaho Barjam Selimaj, Delo Mystehak Sulçaj, Sadedin Sherif Hazizaj, të ekzekutuar në vitet 1943-1944, ndërsa Hito Zenel Hitaj, rënë më 1878 dhe Resul Beqo Resulaj (Onjea) me origjinë nga fshati Vajzë, por rritur dhe nisur për luftë nga fshati Fushëbardhë i Gjirokastrës, i cili ka rënë në luftën e tretë për vilajetin e Janinës më 1897. Amanetin historik të Maliq Sadushit dhe bashkëfshatarëve të tij që ishin në Komisionin për hartimin e historikut të viteve ’70-të të shekullit të kaluar, e bënë realitet bijtë e tyre. Komisioni i para gjysmë shekulli përbëhej nga: Maliq Telo Sadushaj, Xhipe Mersin Kapaj, Gani Mystehak Sulçaj, Riza Çize Brahimaj, Çize Hamit Elezaj, Iljaz Zagoll Bilbilaj, Piro Rexhep Hoxhaj, Fejzi Sherif Sherifaj, Kamo Tare Sheremetaj, Hysen Sadik Brahimaj, Rustem Rrapo Hametaj, Reis Ali Aliaj (Xhezo), Myfit



Zaçe Nazaj, Daver Hamit Elezaj, Mynyr Resul Manaj, Bino Zigur Kasaj, Nasip Halit Xhelilaj. Ishte ky komision që hartoi “Historikun e fshatit Vajzë”, duke u folur brezave me gjuhë “urdhëruese” dhe në fakt bijtë e fshatit Vajzë. Kryetar Irfani, Sokoli, Shkëlqimi, Lefteri, Avniu, kryeplaku Çlirim Hitaj e dhjetëra të tjerë, u përkujdesën në përgatitjen e dokumentacionit e deri në shpalljen e tyre me titullin e lartë “Dëshmorë të Atdheut”, një projekt madhor që për tre vite rresht u finalizua më vendimin e mbledhjes së 11 prillit 2025, si dhe që, më 5 maj 2025, vetë Ministri i Mbrojtjes në cilësinë edhe të Kryetarit të Komisionit qendror shtetëror për statusin “Dëshmor të Atdheut”, erdhi në Vajzë të Vlorës dhe plotësoi atë amanet brezash të shkruar për herë të parë nga gjeneral Maliq Sadushi. Jo vetëm kaq por në Vajzë u ringrit lapidari i ri i dëshmorëve, në formatin e një kompleksi memoristik për dëshmorët, tani jo më për 27 dëshmorë por për 38 dëshmorë të Atdheut dhe një tjetër në proces. Nga ana tjetër djemtë, bijtë dhe bijat e fshatit Vajzë kanë në proces një libër “Yje mbi Beun”, një homazh, respekt e mirënjohje për të gjithë të rënë, në të gjitha epokat, një libër që pritet që së shpejti të jetë në duart e mbrojtësve të gjakut të dëshmorëve dhe të Luftës Antifashiste të shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore.

Maliq Sadushi për Mehmet Shehun dhe të vërtetat e shekullit të shkuar

I ndërgjegjshëm për misionin në jetë, Maliq Sadushi nuk qëndroi në hije dhe nuk anashkaloi të vërtetat e shekullit që shkoi. Kështu sikurse kemi cituar Maliq Sadushi shkroi librin “Mehmet Shehu, siç e kam njohur: kujtime”, 2008. Ai është i qartë, i kthjellët, bindës në argumente. Por ne kemi sjellë vetëm disa fragmente të librit: “...Një gjë e vërtetë është tek unë (që unë nuk dua ta besoj), që Enveri nuk e donte Mehmetin ose e donte të tillë siç përfundoi... Fundi i Mehmet Shehut nuk ka shumë lavdi, ishte një fund tragjik që askush nuk mund ta merrte me mend. Por fundi i tij ka kurajë prej burri, prej luftëtari, prej shoku që kishte prerë në besë shokët dhe që u pre në besë nga shokët... Duke e thënë ndershmërisht, ne pranojmë edhe përgjegjësinë individuale, por edhe kolektive për lejimin e situatave të tilla. Nëse heqim paralele mes këtij fakti të 17.12.1981 me kohën e tanishme, do të kuptojmë të vërtetën e intrigave dhe kulisave kundër shtetit shqiptar dhe partisë ...nga agjenturat e huaja, por ka edhe absurditet të tjera... pas vdekjes së Mehmet Shehut, le të bëjmë një kthim në të kaluarën! Duhet të pohojmë gjërat më të mira të kohëve të sotme dhe gjërat më të mira të kohës së kaluar, të bëjmë kombinimin mes tyre. “Jeta

është shkollë” dhe gjithë bota është një klasë që mësojnë të gjithë! Vrasje apo vetëvrasje? Edhe njëzet vjet pas eliminimit të Mehmet Shehut njerëzit vazhdojnë të pyesin: Vrau veten apo e vranë. Ja ajo që di unë dhe që kam besim se i afrohet së vërtetës. Ajo është enigma e ditë-natës së Mehmet Shehut, por edhe tragjedisë së tmerrshme që ndodhi tek ne, si u bënë udhëheqësit armiq, kur patën treguar me veprimet e tyre në çdo rast se ata qenë njerëzit më besnikë të pushtetit popullor, të popullit... Si u bë e mundur, si nuk menduan të gjithë shokët në Byro, Plenum që e dënuan aq rëndë Kryeministrin më të zotë që kishte nxjerrë Shqipëria? Çdo gjë që u fol kundra Mehmet Shehut ishin sajesa e shpifje të ndyra. E vërteta absolute është së Mehmet Shehu ishte komunist. Veprat e mira atij ia përvetësuan dhe dështimet ia faturuan vetëm atij! Por gjithnjë pas vdekjes së tij. Megjithatë unë mendoj se historia do ta thotë të vërtetën dhe emri, dinjiteti dhe lavdia e Mehmet Shehut do të vihet në vendin që i takon. Mehmet Shehu ishte i vetmi që zbërthente idetë e Enver Hoxhës në çdo fushë dhe ishte ushtar besnik i Partisë! Enver Hoxha vazhdimisht fliste me vlerësime dhe tone të forta, kërkonte se duhej të mësonim nga metoda e Mehmet Shehut. Enveri na porosiste se ‘Partia ka dërguar në ushtri shokun Mehmet Shehu, që është Kryeministër, e kemi shokun tonë të shquar, si i tillë edhe ushtarak me profesion e aftësi të rralla, ai po kontribuon shumë në forcimin e ushtrisë që është garante e mbrojtjes së Atdheut, ndaj përfitonit sa më shumë sa ta keni atje’. Enveri nuk fliste në hava. Ai e kishte bindje këtë vlerësim që bënte për figurën dhe kontributin e krahut të tij të djathtë për 40 vjet me radhë. ..Ishin vite shumë të vështira, mbajti mbi vete shumë detyra të rënda e të vështira, saqë vitet e fundit pesha e këtyre punëve, sëmundja e gjatë, bëri që të lëkundet, u bë dyshues dhe nën këshillat e këqija që i bëheshin dhe informatat e rreme që vinin nga dikush, arriti deri aty sa që gabimi më i vogël të shërbente si pretekst për të ngritur një Alibi të madhe! Sigurisht që pa firmën e tij nuk bëhej gjë, por duke pasur rreth tij njerëz të paqëndrueshëm, patjetër që gabimet e mangësitë do të trasheshin e s’mund të ishte ndryshe. Kështu depërtuan armiqtë në udhëheqjen deri në organet e shërbimet e hetimit, survejimit, ndjekjes e ndëshkimit! Kishte defekte për arsye të mjeteve të asaj kohe; Partia asnjëherë nuk ka ushtuar një kontroll të mjaftueshëm mbi shërbimin e Sigurimit të Shtetit. Jo se nuk donte, nuk ishte në gjendje dhe nuk kishte as përvojën, as përgatitjen dhe as mundësinë! Natyrisht, ne jetuam e punuam në kushtet e partisë-shtet. Tek ne ishte në pushtet një parti e vetme, ajo fliste dhe asaj duhej t’i bindeshe, ajo tregonte rrugën që duhej ndjekur dhe ishte e palejueshme të shkoje kundër Partisë. Partia ishte forcë e madhe, por duhej administruar me kujdes. Megjithatë edhe ajo bën gabime! Sigurisht shumë e kanë pësuar! Kemi kaluar periudha të vështira, por mendoj se ato që do të vijnë do të jenë edhe më të vështira!...Të vërtetat historike nuk mund t’i fshihen historisë. Prandaj edhe nderohet dhe do të nderohet gjithmonë zotësia, aftësia, mençuria... e drejta zhytet por nuk mbytet!

Ushtaraku i lartë, simbol i urtësisë, mençurisë dhe vlerave labe

Për veprimtarinë tij në luftë dhe në punë Maliq Sadushi është vlerësuar me urdhra, dekorata dhe medalje. Kështu nga të dhënat arkivore gjejmë se ka pasur këto vlerësime nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë dhe konkretisht me medaljet sipas urdhrave: me urdhër nr. 9194, datë 9.7.1945 i është dhënë “Medalje e Çlirimit”; me urdhër nr. 4902, datë 6.12.1948 i është dhënë “Medalje e Trimërisë”; me urdhër nr. 7964, datë 15.2.1950 i është dhënë “Medalje e Kujtimit”; me urdhër nr. 1040, datë 25.6.1953 i është dhënë “Medalje Ylli i Kuq Klasi II”; me urdhër nr. 1575, datë 20.11.1952 i është dhënë “Medalje Shërbimi Ushtarak”; me urdhër nr. 2163, datë 8.11.1955 i është dhënë “Medalje me Urdhrin e Trimërisë”; me urdhër nr. 2916 datë 22.6.1959 i është dhënë Urdhri “Skënderbej” Klasi II”; me urdhër nr. 4020, datë 1.7.1965 i është dhënë Urdhri “Skënderbej”, Klasi II; me urdhër nr. 4401, datë 7.6.1969 i është dhënë Medalje e Shërbimit Klasi II. Me urdhër nr. 5675 datë 27.1.1978 i është dhënë Urdhri “Skënderbej” Klasi I. Por puna e tij ka qenë e palodhur, fisnike, e pandalshme; dy herë në dy legjislatura deputet i rrethit të Vlorës, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Maliq Sadushi ishte dhe ngeli deri në fund të jetës bir i denjë i Labërisë, vlerë e urtësisë dhe mençurisë labe, që i njihte mirë zakonet e traditat, ishte atdhetar dhe luftëtar i përkushtuar i zhvillimit dhe vlerësimit figurave të shquara historike krahinore dhe kombëtare të zinin vendin e merituar. Ai ishte në çdo kohë pranë banorëve dhe fshatrave të Labërisë, kontribuoi për zhvillimin e tyre, duke trokitur në dyert më të mëdha të shtetit, duke e dashur me zemër vendlindjen kërkonte përparimin e ekonomisë së kooperativave dhe ngritjen e mirëqenies së ekonomisë fshatare, kudo në Labëri. Maliq Sadushi është nismëtar për ngritjen e bustit të poetit kombëtar nga Vajza, Ali Asllani. Ja amaneti i dytë i tij në librin “Fshati ynë i mirë” për ngritjen e bustit të Ali Asllanit në mes të fshatit (faqe 202): “... Dëshiroj të them se do të ishte në nderin e fshatit Vajzë, që këtë burrë të madh historik (Ali Asllanin), ta nderonin edhe më shumë, ta kishim gjithnjë përpara syve portretin e tij, nëpërmjet vendosjes së një busti në bronz, në qendër të fshatit. Ky është një problem që duhet doemos të gjejë rrugëzgjdhje ligjore, por edhe me kërkesën e banorëve të fshatit”, tashmë një amanet i përmbushur. Por vëmendja ndaj Vajzës është sot amanet i të parëve edhe i Xha Maliqit (sikurse e thërrisnin në fshat vitet e fundit të jetës së tij), amanetin e vijnë Nertili, Irfani, Sokoli, Mitati, Lushi, Arjani, Shkëlqimi, Nexhipi, Gazi, Çlirimi, Levzati, Xhevairi, Bedriu, Dritani, Admiri, Ziniu, Kolonel Avni Bilbili, e qindra djem e vajza të tjerë të këtij fshati me rrënjë mëmëdhetare. Vlerësimet për Maliq Sadushin, misionarin e fisnikërisë dhe mirësisë njerëzore, duhet të vijnjnë, sepse është dhe ka ngelur vlerë e krenari e Labërisë dhe mbarë vendit, edhe pse ka një dekadë e gjysmë që është shuar, por vepra e tij dhe mirësia njerëzore nuk mund të shuhen kurrë, pasi janë frymëzim për brezat. Ai nuk përtoi kurrë të ulej këmbëkrqy fshatçe për hallet e fshatit, krahinës, trevës labe. Fshati, Bashkia Selenicë, Qarku, Prefektura, strukturat e Mbrojtjes, Labëria dhe organizatat e tjera shoqërore duhet ta nderojnë e respektojnë si një prej vlerave më të çmuara krahinore dhe kombëtare.

Burimet e studimit: Dokumente arkivore të AQSH, AQFA, QPR, dosjet etj.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Forca që nuk bërtet, por ndërton

Një reflektim për rolin, sfidat dhe rëndësinë e grave në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të mbrojtur. Në botën ku forca shpesh identifikohet me zë të lartë, qëndrime të rrepta dhe dominim, gruas i kërkohet të përshtatet në një sistem që nuk e ka krijuar ajo, por që e detyron të transformojë veten për të mbijetuar. Kjo është një padrejtësi strukturore e fshehur nën kostumin e përditshëm të normalitetit. Ironikisht, për të qenë “e fortë”, një gruaje shpesh i kërkohet të jetë si burrat – të ndrydhë feminilitetin, të veprojë me autoritet të ftohtë, të ndërtojë një mburojë mbi ndjeshmërinë. Kjo nuk është barazi. Kjo është adaptim në kushtet e pabarazisë.

Gratë, për të ndërtuar një vend në botën profesionale, politike apo institucionale, shpesh ndihen si të huaja në hapësirat ku i kanë mbërritur me përpjekje, sepse prania e tyre nuk është ende normalitet i pranuar. Dhe kjo i bën më të forta.

Forca që lind nga padrejtësia

Kur një grua ecën përpara përkundër një realiteti që e nënvlerëson, ajo nuk është thjesht e suksesshme, ajo është rezistente. Forca e gruas nuk qëndron vetëm në arritjen e objektivave, por në aftësinë për të kapërcyer pengesat strukturore: seksizmin, pabarazinë, mungesën e përfaqësimit dhe presionin e dyfishtë të roleve si profesioniste dhe si nënë. Në çdo hap përpara, ajo thyen një tabu.

Gratë që arrijnë pozicione të larta, rrallë e bëjnë këtë përmes privilegjeve. Ato ecin mbi terren të vështirë, duke sfiduar stereotipa, shpesh pa mentorë, pa rrugë të shtruara, pa rrjete mbështetëse. Suksesi i tyre është një akt që përfaqëson shumë më shumë sesa vetja përfaqëson një brez, një shpresë, një ndryshim të heshtur.

Realiteti shqiptar

dhe sfidat gjinore

Në Shqipëri, çështjet e barazisë gjinore dhe të feminizmit janë ende në proces konsolidimi. Në qytetet e mëdha ka përparime, por në zonat rurale apo në qytetet e vogla, mentalitetet patriarkale vazhdojnë të jenë mbizotëruese. Edukimi, kultura, politika dhe ekonomia nuk ofrojnë ende një terren të drejtë dhe të hapur për gratë.

Emancipimi kërkon jo vetëm masa ligjore, por edhe ndryshim kulture. Shoqëria ka nevojë për edukim të vazhdueshëm, për mbështetje konkrete institucionale, për politika të orientuara drejt fuqizimit të grave jo vetëm si akt simbolik, por si mjet zhvillimi të qëndrueshëm kombëtar. Kjo është e domosdoshme jo vetëm për drejtësi sociale, por për forcim të vetë mbrojtjes kombëtare, sepse një vend që fuqizon gratë, fuqizon vetveten.

Gruaja në uniformë: kur ndjeshmëria

është armë force

Në fushën ushtarake, gratë përballen me sfida të shumëfishta. Të jesh grua në uniformë do të thotë të tejkalosh jo vetëm përballjet me rrezikun dhe disiplinën, por edhe paragjykimin që buron nga fakti se je grua në një mjedis tradicionalisht mashkullor.

Por gratë që shërbejnë në Forcat e Armatosura, në Policinë e Shtetit apo në struktura të tjera të mbrojtjes janë dëshmi se ndjeshmëria dhe forca nuk janë të kundërta. Ato përfaqësojnë guximin e përballjes, por edhe urtësinë e reflektimit. Ato janë garancia që mbrojtja e vendit nuk është vetëm çështje teknike, por edhe morale.

Gratë që nuk kërkojnë privilegje, por të drejtën për të kontribuar

Barazia gjinore nuk nënkupton trajtim të veçantë. Gratë nuk kërkojnë të favorizohen, por të mos pengohen. Ato kërkojnë që mundësitë të jenë të barabarta, që vlerësimi të jetë mbi meritë, që pjesëmarrja të mos kushtëzohet nga paragjykimi,

Forca e gruas, shtyllë e qëndresës dhe e mbrojtjes shoqërore



por të udhëhiqet nga profesionalizmi.

Për shumë gra, suksesi nuk është thjesht një objektiv personal, është një betejë simbolike. Ato nuk luftojnë vetëm për veten, por për një gjeneratë që vjen pas tyre, për vajzat që rriten sot dhe që duan të besojnë se gjithçka është e mundur.

Gratë e forcës: shpresë për ndryshim

Gratë e forta janë ato që vendosin standarde të reja, që ndryshojnë mënyrën se si kuptohet udhëheqja, që përballen me sfidat pa humbur dinjitetin. Në çdo fushë, nga ekonomia te arsimi, nga politika te mbrojtja, ka gra që sfidojnë status quo-në dhe ndërtojnë një shoqëri më të drejtë.

Ne duhet t'i njohim ato, t'i përkrahim, t'i promovojmë. Sepse kur gratë ngrihen, shoqëria ngrihet. Kur gratë janë të pranishme në vendimmarrje, drejtësia nuk është më një iluzion, por një realitet i mundur.

Gratë si arkitekte të paqes

dhe të sigurisë

Roli i gruas në mbrojtjen kombëtare nuk është thjesht simbolik. Është thelbësor. Ajo është zë që sjell qartësi, dorë që shëron, mendje që planifikon dhe zemër që sakrifikon.

Në një epokë ku sfidat e sigurisë janë komplekse dhe kërkojnë qasje gjithëpërfshirëse, gratë janë pjesë e zgjidhjes.

Ato janë forca që nuk e kërkojnë vëmendjen, por e meritojnë. Ato janë mbështetëse të paqes, por edhe mbrojtëse të së drejtës.

Siç e thotë bukur Amy Rees Anderson: “Ne duhet t'i njohim gratë e forta, ne duhet të jemi ato, ne duhet t'i ngremë ato sa më lart.”



QERIME HALIL GALICA – SHOTA, luftëtarja e shquar për lirinë e Kosovës



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Lindi në vjeshtë të vitit 1895, në Radisheva të Drenicës në familjen e njohur të Halil Radishevës. Prindërit dhe rrethi familjar e pritën me gëzim lindjen, se ishte motra e vetme e gjashtë vëllezërve. Për këtë u shti pushkë, dhe pse nuk ishte zakon të veprohej kështu, kur lindte vajzë. E quajtën Qerime, ndërsa në trevat shqiptare këtu e një shekull njihet me emrin Shotë. Shotë, kosovarët i thonë rosës. I ati s’e kishte quajtur kështu kot, sepse me këtë emër në Kosovë, iu thërrasin vajzave me trup të vogël e topolake. Saliu dhe Mehmeti, dy vëllezërit e saj të mbetur nga barbarizmat e armiqve, kanë theksuar se Qerimja në fëmijëri ishte me shtat të shkurtër dhe babai me përkëdhelje e thërriste “Shota e babës”. Nuk mund t’i kishte shkuar ndër mend se kështu, i kishte vënë një emër të dytë, me të cilin filluan ta thërrisinin jo vetëm në familje, por krejt Radisheva, Drenica, Kosova dhe mbarë Shqipëria.

Oda, vendi ku mori mësim dhe edukim

Në formimin e Shotës ndikoi së tepërmi i ati, Halil Radisheva, që e merrte përherë në oda ku mblidheshin burra. Në Drenicë në atë kohë nuk kishte shkollë, prandaj Shota mësoi në shkollën e jetës, në kuvende dhe në betejë, që në këtë kohë ishin bashkudhëtarë të jetës në Kosovë. Kështu, si në krejt malësitë shqiptare edhe në Drenicë ka ekzistuar oda. Ajo ka zëvendësuar zbrazësinë e mungesës së arsimit. Sipas traditës, oda ishte një farë institucioni tradicional mësimi dhe edukimi, ku derdhej dija e pafund e urtësisë popullore. Aty, me orë të tëra bëheshin kuvende, me zë të qetë e të matur, aty tregoheshin kujtimet e historisë së lavdishme, aty lëvdoheshin shembujt më të bukur të trimërisë, të nderit dhe të besës, aty shfrynte dufi dhe urrejtja për pushtuesit e veglat e tyre. Duke ndenjur afër të atit, vajza përpiquej t’i shëmbëlente më tepër atij. Me kënaqësi e dëgjonte atë, kur tregonte se si gjatë dekadave të shkuara malet, grykat dhe fushat shqiptare ishin bërë shesh betejash të përgjakshme. Dëgjonte më të mëdhenjtë dhe blinte mend prej tyre. Mësoi për luftërat e zhvilluara para dhe gjatë Lidhjes së Prizrenit, në rrethinat e Nishit, Vranjës, Prekuplës, Kuishumlisë, Leskocit, Kumanovës, për betejat legjendare në Lim të Plavës, në grykat e Kaçanikut e Cemalëvës, ku burrat e Drenicës kishin lënë nam. Të gjitha këto ngjarje i rrënjosën Shotës dashurinë për lirinë dhe admirimin për patriotizmin e të parëve. Kjo edukatë që mori në fëmijëri la gjurmë në gjithë jetën e saj. Fshati ku lindi Shota quhet Radishevë. Ai ndodhet në skajin veriperëndimor të Drenicës. Radisheva ka historinë e vet. Aty janë zhvilluar shumë luftëra kundër pushtuesve osmanë, turq, austriakë dhe serbo-malazezë. Vetëm brenda 10 vjetëve (1909-1919) Radisheva ishte djegur dhe shkatërruar tri herë, një herë nga turqit dhe dy herë nga pushtuesit serbo-malazezë. Që të tria këto djegie i jetoi dhe Shota. Gati gjithë verën e vitit 1909, Shota dhe fëmijët e Radishevës, u endën nëpër ara e kopshte, që të gjenin ushqime për të ngrënë e jetuar.

Shota bëri histori

Kullë më kullë e katund më katund të Drenicës u hap lajmi se nusja e Azem Galicës kishte dalë në mal. Kudo me habi pyesnin: “Qysh, një nuse e re me dalë maleve me burra?”. Ndërsa nëna e Azemit u përgjigjej: “E çka jemi na, gratë, ma pak se burrat? Kur grueja del maleve për liri nuk asht marre, po asht nderë e trimni, asht grue përmbi burrat”. Azemi e Shota shkuan në malin e Çiçavicës, që gjithmonë ishte njohur si kalaja më e sigurt për luftëtarët e Drenicës. Të nesërmen, nga shpatet e malit, panë flakën e tymin që ngrihej mbi shtëpinë e tyre, e cila u dogj prej xhandarëve serbë. Duke dashur t’ua largonte mendjen nga hidhërimi, Shota iu drejtua Azemit dhe Ademit: “Mos u mërzitni! Shpeshherë Kosova asht vra e djegë dhe të parët tanë në vend të lotëve i kanë rrokë pushkët. Qe, edhe unë nuse jam, dhe në vend të gjyplanës për me qëndisë kapa pushkën dhe erdha me ju”. Dalja e Shotës në mal ishte një hap i dyfishtë guximi, sepse ajo hidhej në luftën e gjatë kundër pushtuesve të huaj, e, njëkohësisht, shkelmonte zakonet prapanike mbi gruan. Dhe, po të kujtojmë atë kohë, kur po të shihej një grua midis burrave, të gjithë ulnin kryet, kuptohet edhe më mirë trimëria e kësaj nuseje shqiptare 19-vjeçare, e cila, me guximin e saj kreshnik, shkeli kanunin, grisi hijen e paragjyqimeve të rënda, veshi rrobat e komites kombëtare, kapi pushkën dhe doli maleve midis burrave, duke u ndeshur dhëmb për dhëmb, jo vetëm me xhandarët dhe ushtrinë serbe, por edhe



me “xhandarët e ushtrinë” e paragjyqimeve poshtëruese ndaj gruas. Mendimin e vjetruar, se gruaja nuk ka personalitetin e vet, Shota e haste në çdo hap, ai i qe bërë një ferrë që e ndiqte kudo e që nuk iu nda edhe në ato skuta ku nuk mundte të arrinte dora e fuqisë armike. Pëshpëritjet se ajo e “koriti” shtëpinë apo fisin, e të tjera koncepte reaksionare, ishin një kundërshtar me të cilin Shota u ndesh në çdo hap, në çdo kullë dhe katund. “Zakoni prapanik, - u thoshte shpesh Shota shokëve dhe shoqeve të saj, - më asht ba gati si xhandarët e Serbisë”. Vitet kalonin. Aksionet ndiqnin njëri-tjetrin. Lufta, ashtu si puna, e tregon njeriun. Njeriu i luftës së drejtë, ashtu si njeriu i punës, nuk thyhet. Heronjtë e vërtetë kurrë as nuk përkulen, as nuk kthehen mbrapa. Përkundrazi, ata gjithmonë ecin përpara me guxim. Kështu ndodhi edhe me Shotë Galicën, e cila me heroizëm çau përpara, duke u përpjekur, ditë e natë, me pushkë, me zemër e me mendje, për të thënë fjalën e vet, fjalën e gruas shqiptare për lirinë e Kosovës.

Çetë më çetë e mal më mal, ku luftoi e shkeli këmba e Shotës, “burrat e dheut”, që më parë nuk donin as të dinin ç’ ishte gruaja, ata që në fillim kishin ulur kryet kur kishin një grua midis tyre, ata që në muajt e parë nuk deshën as të besonin se si një grua mund të qe një luftëtare e barabartë me ta nëpër male, dalëngadalë, duke parë qëndresën e saj, filluan ta vlerësonin e ta nderonin, madje t’i këndonin edhe këngë lavdërimi e trimërie, që dikur ua thurnin vetëm luftëtarëve më të dalluar.

Me luftën e saj, Shota i mbylli gojën kujtdo dhe vërtetoi se, duke u radhitur midis shoqërisë së luftëtarëve të lirisë, nuk e koriti, por e nderoi fisin, shtëpinë dhe gjirin e nënës së vet. Ajo e ngriti më lart figurën e gruas shqiptare, ngriti më lart nderin, trimërinë dhe besnikërinë e pastër të nuses kosovare. Kështu, me luftë e përpjekje të mëdha, Shota mundi të hynte në histori. Javë e muaj kalonin. Gjithnjë e më tepër populli i Drenicës njihte rolin dhe emrin e Azemit e të Shotës dhe bijtë e këtij vendi arbëror nisën të lidheshin dhe të bashkëvepronin me ta.

Kalorëse e stërvitur e luftërave për liri

Në krahinën e Drenicës, e cila ishte ndarë me vijë demarkacioni midis pushtuesve austro-hungarezë dhe bullgarë, vepronin pa pushim luftëtarët trima të Azemit dhe të Shotë Galicës. Lufta e tyre nuk u kufizua në një qëndresë pasive e në një rreth të vogël, por kaloi kufijtë lokalë e u shpreh në shumë përpjekje e sulme mbi postat e territorit të Drenicës, të Mitrovicës e të Vuçiternës. Çetat dhe grupet e Drenicës në zhvillimin e tyre filluan të kishin të qartë konceptin e manovrimit; luftë me lëvizje e me zhvendosje të largëta, kalime herë në zonën austriake, herë në atë bullgare, veprime të çetës herë në grupe, herë të gjithë bashkë, organizim pritash dhe goditje në befasi etj. Vargu i përpjekjeve të Azemit e të Shotës kundër austro-bullgarëve është i madh. Në ditët e ftohta e plot borë, aty nga muaji shkurt 1916, duke kaluar nëpër katundin Lush (në afërsi të Mitrovicës) Azemi, bashkë me shokët e tij, ra në përpjekje me

forcat armike, por nuk pësoi asnjë dëm. Gjatë vitit 1916 Azemi, me një grup shokësh, në afërsi të Galicës, organizoi një pritë kundër xhandarmërisë armike dhe post-komandantit të saj në Mikushnicë. Në dimrin e viteve 1916-1917, çeta e Azemit, nga ndjekjet e forcave austriake, u shtrëngua të shpërndahej në grupe dhe Azemi, Shota e Ademi, mbas një përpjekjeje me austriakët, kaluan në zonën e pushtuar nga bullgarët dhe u strehuan në katundin Obrij. Shota i kishte rënë kryq e tërthor Mitrovicës pa ia bërë syri e veshi tërr. Qyshse u njohën për drejtues të luftëtarëve të Drenicës, Azemi e Shotë Galica kërkuar që secili luftëtar të ishte i disiplinuar, trim, të sillej mirë me popullin, pa dallim feje dhe kombësie. Me këto ide dhe me luftën guximtare kundër sundimit austriak e bullgar gjatë viteve. 1916-1918, çeta trime e Drenicës dhe emri i Azemit e Shotë Galicës u bënë të njohur dhe të dashur për të gjithë popullin e Kosovës, derisa Azemi, më 17 korrik 1924, vdiq nga plagët e marra në betejë. Në dimrin e vitit 1926-1927, Shota kërcënohej jo vetëm nga plagët por edhe nga uria. Më 14 dhjetor 1926, në një kërkesë drejtuar organeve të administratës shtetërore të kohës, ndër të tjera ajo u shkruan: “Unë jam e shoqja e Azem Galicës nga Kosova... Gjindem në katundin Shullaz të Krujës. Ndodhem me katër fëmijë e jam tue vdekë nga uria”. Por administrata zogolliane as nuk desh të dinte nëse jetonte e jo më ta ndihmonte fatosen e luftërave për liri. Madje mbreti donte edhe të hakmerrej. Ai nuk harronte se ajo qe e shoqja e Azem Galicës, i cili, qysh në vitin 1920, bashkë me patriotin Hasan Prishtina, kishte mbrojtur me të gjitha forcat atdheun dhe i ishte kundërvënë Zogut, që ishte vegël e serbomëdhenjve. Shota sa vinte keqësohej. Plagët iu acaruan. Me kujdesin e bashkëluftëtarëve dhe mjekëve patriotë ajo mundi të shtrohej pak ditë në spitalin e Tiranës, që në vitin 1927, ndodhej afër sahatit të kryeqytetit. Në këto kushte ajo u detyrua të largohej e të shkonte në Derven. Këtu kaloi ditët e fundit të jetës. Kështu, një ditë të fund-korriku të vitit 1927, në moshën 32-vjeçare, e tretur në mjerim, vdiq luftëtarja e



shquar për lirinë e Kosovës, Qerime Halil Galica - Shota. Heronjtë gjithçka ia falin atdheut. Ata edhe pas vdekjes duan që trupin e varrin e tyre ta vënë në shërbim të tij. Prandaj, në çastin e fundit të jetës, Shota u la porosi bashkëluftëtarëve që ta varrosin buzë rrugës Shkodër-Tiranë, afër qendrës së Fushë-Krujës. Kështu ajo, siç ka qenë traditë e heronjve të lashtë, donte t’i ngjatjetonte e t’i thoshte çdo kalimtar: “Udhëtar! Mos harro, këtu pushon trimnesha shqiptare që 12 vjet me pushkë në dorë nëpër malet shqiptare luftoi për lirinë e Kosovës”. Qerime Halil Galica (Shota) është shpallur dëshmore e Atdheut, me vendim nr.154, datë 25 nëntor 1978, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Krujë. Ajo mban titullin e lartë “Heroinë e Popullit”. Për heroinën është shkruar në vijimësi, është bërë një monografi “Shota dhe Azem Galica”, janë ngritur buste si dhe thurur e kënduar mjaft këngë.

Kur Ndjeshmëria bëhet Turp: Pandjeshmëria si virtyt Modern

SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE
ANJEZA MUSOLLARI

Pandjeshmëria si sëmundje moderne

Në një botë gjithnjë e më të shpejtë, të teknologjizuar dhe të zhurmshme, ku informacioni vjen me shpejtësinë e dritës, njerëzimi është duke humbur një nga virtytet më thelbësore të ekzistencës së tij: ndjeshmërinë. Pandjeshmëria, nga një anomali morale dikur e rrallë, është shndërruar sot në një “modë” të pranueshme shoqërore. Ajo nuk shfaqet më si devijim i sjelljes, por si mjet mbijetese. E gjithë kjo na çon drejt një shoqërie të akullt, ku empatia shihet si dobësi, e ku qëllimi i justifikon çdo mjet, sado i pamëshirshëm qoftë ai.

Pandjeshmëria si produkt i shoqërisë konsumiste

Pandjeshmëria nuk është një fenomen që lind nga hiçi. Ajo është produkt i drejtpërdrejtë i shoqërisë së konsumit, ku individi vlerësohet jo për atë që është, por për atë që ka. Në një realitet ku fitimi, imazhi dhe suksesi janë bërë qëllime të jetës, ndjeshmëria humbet vlerën e saj. Ajo shihet si pengesë në garën për mbijetesë dhe dominim.

Njerëzit trajtohen si mjete dhe jo si qëllime. Ndaj është e zakonshme të shohim rrjete sociale plot me ironi, përbuzje, cinizëm, urrejtje ndaj atyre që mendojnë ndryshe, ndaj të dobëtëve apo thjesht ndaj atyre që guxojnë të jenë të ndjeshëm. Gjithçka që s’përputhet me imazhin e “njeriut të suksesshëm”, të fortit, të ftohtit emocionalisht, të vendosurit me çdo kusht refuzohet dhe nëpërkëmbet.



Rrjetet Sociale: Arena e pandjeshmërisë virtuale

Në rrjetet sociale, fenomeni i pandjeshmërisë është thelluar dhe normalizuar. Njerëzit ndihen më të lirë për të gjykuar, tallur, përcmuar dhe ofenduar, të fshehur pas një profili digjital. Mungesa e kontaktit të drejtpërdrejtë u jep guxim që në jetën reale nuk do ta kishin.

E kemi parë dhjetëra herë: një viktimë dhune poston historinë e saj, dhe nën komente shfaqen fjalë fyese, që e fajësojnë apo e nënçmojnë. Një njeri i depresionuar kërkon ndihmë dhe përgjigjet që merr janë të tipit “bëhu burrë”, “mos u bë viktimë”. Ky është një kulm i pandjeshmërisë të mos jesh në gjendje të pranosh ndjeshmërinë e dikujt tjetër, dhe jo vetëm kaq, por ta ndëshkosh për të.

Rënia e vlerave emocionale

Një faktor tjetër i rëndësishëm është mungesa e edukimit emocional, që duhet të nisë në familje dhe të vazhdojë në shkollë. Në shumë raste, fëmijët rriten me idenë se “nuk duhet të tregojnë ndjenjat”, sepse ndjenjat i bëjnë të dobët. Meshkujt, veçanërisht, mësohen që qajta është turp, empatia është e tepërt, dhe se duhet të jenë të ftohtë dhe racionalë gjithmonë. Kjo është një recetë për të krijuar breza të mbyllur emocionalisht, që nuk ndihen rehat me vetveten, dhe që nuk kanë as ndjeshmëri për të tjerët. Në shkollë, po ashtu, fokusi është tek notat, performanca dhe disiplina dhe jo tek ndjeshmëria, solidariteti dhe bashkëjetesa. Kështu krijohet një boshllëk emocional që më vonë manifestohet në marrëdhënie të thyera, në mungesë empatie dhe në izolim shoqëror.



Vetë-mashtrimi i Epokës Moderne

Ndonëse duket paradoksale, shpesh pandjeshmëria është thjesht një mënyrë për të mbijetuar emocionalisht. Në një botë ku ka shumë dhimbje, padrejtësi dhe fatkeqësi, ndjenja e empatisë mund të jetë e padurueshme. Disa zgjedhin të “mbyllin zemrën” për të mos ndjerë dhimbje. Ata e ushqejnë veten me fraza si “kështu është jeta”, “çdokush e ka për vete”, “nuk më intereson”, “ç’më duhet mua”. Këto janë formula që i largojnë nga barra morale e ndjeshmërisë. Ky është një vetë-mashttrim që i jep individit ndjesinë e kontrollit dhe të sigurisë, por në realitet e shkatërron gradualisht kapacitetin për të ndjerë dhe për t’u ilidhur me të tjerët.

Njerëz të vetmuar në turmë

Pandjeshmëria nuk është e dëmshme vetëm për ata që e përfetojnë nga të tjerët. Ajo është helmuese edhe për vetë individin që e ushqen atë. Të jesh pandjeshëm është të jetosh në një shkretëtirë emocionale, ku asgjë nuk ka thellësi, ku marrëdhëniet janë sipërfaqësore dhe ku vetmia bëhet shoqëruese e përhershme. Në plan më të gjerë, një shoqëri pandjeshmërie krijon ndarje të thella, rrit nivelet e dhunës, përjashtimit dhe diskriminimit.

Pandjeshmëria është themel i urrejtjes ndaj të ndryshmes, i intolerancës fetare, racore apo gjinore. Ajo është rrënja e ftohtësisë së institucioneve, e padrejtësive sociale dhe e heshtjes përballë të keqes. Nëse pranojmë që pandjeshmëria është një sëmundje shoqërore, atëherë duhet të kërkojmë shërim. Dhe ky shërim nuk mund të vijë nga teknologjia, ligjet apo propaganda, por nga individi, nga secili prej nesh. Si psh nga kultivimi i ndjeshmërisë që në fëmijëri. Fëmijët duhet të mësojnë të ndihen, të pranojnë emocionet dhe të mësojnë të vënë veten në vendin e tjetrit. Kjo ndjesi duhet të ngulitet si vlerë, jo si dobësi. Promovimi i shembujve pozitivë: Media dhe rrjetet sociale kanë fuqi të madhe për të formësuar perceptime. Në vend të lavdërimit të personazheve cinikë dhe të ftohtë, duhet të promovohen figura që mishërojnë ndjeshmëri, empati dhe humanizëm. Rikthimi te vlerat njerëzore dhe shpirtërore: Pandjeshmëria është mungesë e shpirtit. Rikthimi te meditimet, arti, letërsia, natyra dhe besimi mund të ndihmojë njerëzit të rigjejnë ndjeshmërinë e humbur. Në fund të ditës, ajo që na bën njerëzorë nuk është fuqia për të fituar, për të manipuluar, për të dominuar apo për të mbijetuar mbi kurrrizin e tjetrit. Ajo që na bën njerëzorë është aftësia për të ndjerë, për të dhembhur, për të kuptuar, për të dashur dhe për të qenë pranë njëri-tjetrit.

Ndjeshmëria nuk është luks. Ajo është themeli i çdo shoqërie të shëndetshme. Është busulla morale që na tregon drejtimin në një botë gjithnjë e më të humbur. Nëse nuk e

rimarrim atë në zemrat tona, rrezikojmë të mbetemi vetëm genie biologjike pa shpirt, pa kuptim, pa njerëzillëk.

Pandjeshmëria si “virtyt” modern

Në kulturën e sotme, ftohtësia emocionale shpesh interpretohet si pjekuri. Njeriu që nuk ndikohet nga dhimbja e tjetrit shihet si “i fortë”, “i zoti të mbijetojë”. Në rrjetet sociale, për shembull, tallja me dështimin apo tragjedinë e dikujt kthehet në argëtim masiv. Në jetën e përditshme, indiferenca ndaj halleve të fqinjit shihet si “normalitet”. Ky mentalitet krijon një logjikë të rrezikshme, nëse ndjeshmëria është turp, atëherë vetëm pandjeshmëria garanton respekt dhe pushtet. Pikërisht këtu lindin krizat sociale, dhuna mes adoleshentëve, te shpërfillja e vuajtjes njerëzore në shoqëri.

Shkaqet e fenomenit

Kultura e konkurrencës ekstreme ku sistemi shoqëror shpërblen individin që fiton, jo atë që ndihmon. Mediat dhe rrjetet sociale banalizimi i tragjediave për klikime, nxitja e cinizmit dhe ironisë ndaj dhimbjes. Edukimi i mangët emocional shkollat shpesh formojnë mendje, por jo zemra, ku modelet e suksesit janë figura të pandjeshme, që shpesh shfaqen si “të pamposhtur”.

Pasojat në shoqëri

Pandjeshmëria nuk është thjesht një cilësi personale; ajo është një virus shoqëror. Rrit dhunën dhe krimet mes të rinjve, siç kanë treguar ngjarjet tragjike të fundit në Shqipëri. Izolon individin, duke krijuar ndarje mes njerëzve dhe humbje të solidaritetit. Kthen shoqërinë në një arenë të ftohtë, ku secili mendon vetëm për veten dhe ku dhimbja e tjetrit nuk prek më asnjë ndërgjegje.

Rikthimi i ndjeshmërisë si forcë

Në fakt, ndjeshmëria nuk është dobësi, por një nga format më të larta të forcës njerëzore. Shoqëritë që kultivojnë ndjeshmëri ndërtojnë solidaritet, zhvillim dhe humanizëm të qëndrueshëm.

Kur ndjeshmëria quhet turp dhe pandjeshmëria virtyt, atëherë shoqëria është në rrezik të humbasë humanizmin e saj. Moderniteti nuk duhet të shoqërohet me ftohje shpirtërore, por me zhvillim të mendjes dhe të zemrës. Forca e vërtetë e njeriut nuk matet me sa i ftohtë është ai ndaj të tjerëve, por me aftësinë për të qenë pranë në dhimbje dhe në gëzim.

Një shoqëri që lartëson pandjeshmërinë, vret të ardhmen e vet. Një shoqëri që ushqen ndjeshmërinë, ndërton themelet e një njerëzimi më të drejtë, më të shëndetshëm dhe më të lumtur.

Udhëheqësit e kryengritësve në Luftën e Dibrës

(12 Anëtarët e Shtabit Luftarak të Luftës së Dibrës)



Përgatitur dhe përshtatur nga SAKIP CAMI

Qëndresa luftarake 9-vjeçare kundër serbëve për mbrojtjen e territoreve shqiptare është epike e pavdekësisë së kombit tonë. Prijësit dibranë, të mençur nga natyra nuk u pajtuan me vendimet e Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë dhe të Dibrës së tyre dhe tonës. Prijësit dhe luftëtarët u kundërpërgjigjën me forcat e veta, me armët e veta, derisa ia arriti që t’i detyronte ushtritë serbe të tërhiqeshin jashtë kufijve të vitit 1913. Populli dibran mençurisht këtë qëndresë luftarake 9-vjeçare, nga nëntori i 1912 deri në dhjetor 1920, e ka gdhendur në këngë: **“Në tan’ Evropën ka shkue fjala/ Qe nandë vjet luftojmë me krajla”**.

Në luftën e Dibrës u luftua në mënyrë energjike nga gjithë prijësit, luftëtarët dhe populli. Prandaj dhe lavdia i takon mbarë popullit, ndërkohë që edhe prijësit kanë vendin e tyre në historinë e triumfit ndaj gjithë pushtuesve.



Elez Isufi, shqipja e Korabit, ishte dhe mbeti një flakadan lirie në breza

Elez Isufi, prijës i parisë dibrane, plaku i randë i maleve, shqipja e Korabit, plaku i famshëm, filozofi me kësulë të bardhë, mendimtari i madh, diplomati i pashkollë, gjenerali me shajak, kreshniku i maleve të Dibrës, ballina e kombit, atdhetari i flaktë, njeri me cilësi të mbinatyrshme, patriot e atdhetar i flaktë, “flakadan lirie që frymëzoi breza të tërë luftëtarësh për çështjen e madhe të kombit shqiptar, burrë dibran me karakterin e shqiptarëve të hershëm e më atdhedashuri të fortë që nuk iu përul as forcës brutale dhe as arit të huaj”. Elez Isufi u bë korifeu i qëndresës popullore në epopenë e luftërave 9-vjeçare kundër një armiku nga më të tërbuarit e më mizorët i shqiptarëve. Shkriu gjithë pasurinë e tij për interesat kombëtare. U dogjën tri herë kullat e tij, në 1913-ën, në 1918-ën dhe në 1921-in, u internua dhe u burgos familja e tij, u përgjakën burrat e konakut të tij, por ai nuk u thye, as u gjunjëzua, as u përkul. Elez Isufi nga fillimi i vitit 1916 e deri në tetor 1918, me përjashtim të një vizite në Vjenë, ku u dekorua nga Kajzeri, kohën tjetër qëndroi në Sllovë. Me dekret të 28.1.1916, Franc Jozefi, perandori i Austro-Hungarisë dekoroi Elez Isuf Ndreun

me Kryqin e Konturës të Oficerëve të Urdhrit të lartë “Franc Jozef-Orden”, me dekoracion lufte. Arkivat dhe historia do flasë me fletë të ndritura për ngjarjet e mëdha, ku 4 muaj Elez Isufi në dimrin e egër të 1921 qëndroi në shi e në borë në malet e Lurës me malësorët besnikë të Reçit e Dardhës dhe të mbarë Dibrës, duke treguar një trimëri të jashtëzakonshme në mbrojtje të vatanit dhe nuk i lejuan serbët të kalojnë kufirin. Elez Isufi u dekorua për merita të veçanta lufte nga perandori i Austro-Hungarisë Franc Jozefi me titullin e lartë. Fakt është se në pallatin perandorak kishte vënë këmbët me baltë mbi qilimat persianë të salloneve aristokrate një malësor me rroba shajaku, me opinga lëkure. Pa iu dridhur qerpiku ai i drejtohet Perandorit, duke iu drejtuar përkthyesit që mos t’ia ndryshojë fjalët në komunikim, se shqiptarët janë vrarë me osmanët, se ai u kishte kërkuar nizamë e taksa; ishte vrarë me ushtrinë serbe se kishte kërkuar të bëhej zot shtëpie e të mblidhte taksa e ushtarë e se kështu do të vritej me të gjithë ata që janë të këtij soji. Elez Isufin e plagosën më 16.12.1924 bashkë me nipin e tij trim Sufë Xhelilin. Elez Isufi 63 vjeçar vdiq nga plagët e luftës më 30.12.1924. Edhe pse pa shkollë, Oda Dibrane, u bë auditor i “Universitetit të Dibrës” dhe fusha e luftës e pajisi me dijet e një akademie universitare për trimëri si dhe e armatosi me strategjinë e një gjenerali. Historia gdhendi në kujtesën e popullit fjalën e tij të urtë që ndante kanune, shëronte plagë e afronte njerëz.




Ramiz Daci, prijës i luftës së përbashkuar të “nëntë maleve” të Dibrës

Ramiz Daci ishte lindur në një truall atdhetar në vitin 1883, në Dibër të Madhe. Pinjoll i shquar i Fisit dhe familjes Daci të fshatit Zogje dhe qytetit të Dibrës. Shkollën fillore dhe atë gjysmë të mesme i bëri në Dibër, ndërsa maturën dhe Shkollën e oficerëve e mbaroi në Stamboll. Gjuhën shqipe e mësoi nga atdhetari Said Najdeni. Oxhaku i tyre shquhej për pushkë, sofër e besë. Studimet i vijoi në Stamboll në shkollën ushtarake që ishte krijuar që më 1834. Revolucionin xhonturk i 1908-ës e gjen me shërbim në Rekë. Në këtë periudhë filloi edhe aktivitetin e tij publicistik në interes të kombit shqiptar. Ishte ndër të parët që u vu në shërbim të Qeverisë së Vlorës. Ramiz Daci ka qenë shoqërues i Vëhbi Dibrës në shpalljen e pavarësisë në Vlorë, më 28.11.1912. Më 1913 u rreshtua në llogoret e popullit kundër pushtuesit të ri serb. Ka qenë kurdoherë kudo ku luftohej kundër serbit për nëntë vjet rresht. Ai ka qenë

pjesë e ideatorëve për kuvendin e gushtit 1920 të Arrasit. Ramiz Daci ka qenë senator i Senatit të dhomës së Këshillit Kombëtar të Shqipërisë, nga 27.3.1920 deri më 20.12.1920, njëherësh edhe prijës në Luftën e Dibrës. Ai ishte një nga organizatorët kryesorë të kuvendeve dhe luftërave edhe si një prej prijësve të luftës së përbashkuar të “nëntë maleve” të Dibrës. Ramiz Daci u zgjodh jo thjesht anëtar parlamenti por anëtar i senatit, dhomës së lartë të Parlamentit Shqiptar në Kongresin e Lushnjës. Ai ka qenë senator i Senatit të Parlamentit Shqiptar nga 27.3.1920 - 20.12.1920. Ramiz Daci, më 7.8.1920, ishte në Arras ndër organizatorët e një kuvendi me pjesëmarrjen e 3000 vetëve, ku shprehën krenarinë e Luftës së Vlorës kundër italianëve dhe shprehën gatishmërinë për të mbrojtur me të gjitha mjetet tokat dhe atdheun e tyre. Nën drejtimin e prijësve si Ramiz Daci dhe të tjerë drejtues luftarakë dibranë, bazuar edhe në gazetën “Ushtima e maleve”, nr. 28, datë 12.7.1990, “..në luftimet e datës 15.8.1920, kishte 1000 të vrarë nga serbët dhe 2000 të plagosur..” dhe episode luftarake, ku spikat drejtimi i prijësve dibranë janë me dhjetëra në luftën nëntë vjeçare për sovranitet kombëtar. Ramiz Daci në kuvende dhe në beteja ishte krahas prijësve të tjerë si: Ramiz Bej Dibra, Dine Bej Maqellara, Izet bej Maqellara, Selman Alia, Jashar Erebara, Ismail Strazimir, Selë Bajraktari, Shaqir Dema, Dine Dema, Riza Lusha, Dervish Lusha, Dine Hoxha, Selim Noka etj.

Dine Bej Maqellara (Nasufi), prijës në luftën nëntëvjeçare anti-serbe

Dine Nasufi ishte lindur në vitin 1875, në Maqellarë, në një ambient patriotik e luftarak. Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në Dibër. Një oxhak i shquar për të fisëm, anëtar i klubit “Bashkimi” të Dibrës, në 1912. Pjesëmarrës në luftime më 21 qershor 1912, duke drejtuar çetën e Fushës. U shqua në kryengritjet kundër serbëve dhe për këtë serbët ia internuan familjen e tij, në shtator 1920, në Manastir. Në maj të vitit 1912, ishte anëtar i Komitetit Nacional të Dibrës, organ ushtarak kundër pushtuesit turk së bashku me Elez Isufin, Izet Maqellarën, Shaqir Jegenin, Ismail Strazimirin, Sherif Langun, Eqerem Camin etj. Dine dhe Izet Maqellara kanë organizuar rezistencën kundër serbëve, bullgarëve, nemçes etj., sidomos në luftimet 9-vjeçare kundër serbëve 1912-1920. Dine Bej Maqellara dhe paria e Dibrës i dërguan qeverisë së Durrësit një notë për delegacionin që do të merrte pjesë në Konferencën e Paqes të Parisit, më 17.3.1919, në të cilën u kujtojnë se Dibranët janë në trojet e tyre që prej 6000 vjetësh. Në Kongresin e Lushnjës zgjidhet senator. Dine Bej Maqellara ka qenë deputet i Parlamentit Shqiptar nga 27 mars 1920 deri më 20 dhjetor 1920. Ka vdekur në vitin 1928. Në vitin 1992 është dekoruar me urdhrin e Lirisë të klasit II.



(Vijon)



Në universin e fotografisë, ku çdo klikim është një përprjekje për të ndalur kohën dhe për të ruajtur një ndjesi, Fadil Berisha është një nga ata artistë që kapin thjeshtë pamjen – ai kap shpirtin. Me një sy të mprehtë për bukurinë dhe një ndjeshmëri të rrallë për detajet, ai ka ndërtuar një karrierë që është jo vetëm e suksesshme, por edhe frymëzuese për breza të tërë artistësh.

Një emër shqiptar në skenën globale

Fadil Berisha është një nga emrat më të njohur në fotografi, jo vetëm për suksesin e tij profesional, por edhe për mënyrën se si ka përfaqësuar me krenari identitetin shqiptar në arenën ndërkombëtare. Si fotograf zyrtar i Miss Universe dhe Miss USA, ai ka qenë pas kamerës në disa nga momentet më ikonike të botës së modës dhe bukurisë. Portofoli i tij përfshin bashkëpunime me marka prestigjioze si “Vogue”, “Harper’s Bazaar”, “Elle”, dhe “Cosmopolitan”, si dhe me figura të njohura si Tyra Banks, Naomi Campbell, Zana Krasniqi dhe Pia Wurtzbach.

Por ajo që e bën Fadilin të veçantë nuk është vetëm fama – është mënyra se si ai ka ruajtur thjeshtësinë dhe përkushtimin ndaj artit të tij. Ai ka arritur të ndërtojë ura mes kulturave, duke sjellë një frymë shqiptare në çdo projekt ndërkombëtar. Për të, suksesi nuk është vetëm personal – është një mision për t’i treguar botës se çfarë mund të ofrojë një artist nga një vend i vogël me zemër të madhe.

Stili i tij, elegancë, dritë dhe ndjeshmëri

Fotografitë e Fadil Berishës janë të dallueshme në çdo galeri apo faqe reviste. Ai ka një stil të veçantë që kombinon elegancën klasike me modernitetin e sofistikuar. Drita është mjete i tij kryesor – ai e përdor atë jo vetëm për të ndriçuar subjektin, por për të zbuluar emocionin që fshihet pas çdo shprehjeje. Kompozimet e tij janë të balancuara, të pastra, dhe gjithmonë të mbushura me një ndjesi të thellë.

Ai nuk fotografon për të treguar bukurinë sipërfaqësore – ai kërkon autenticitetin, forcën, dhe brishtësinë që e bëjnë një njeri të veçantë. Në portretet e tij, mund të ndjesh historinë e subjektit, betejat e tij të brendshme, dhe dritën që e bën të shkëlqejë. Ky është arti i vërtetë i Fadil Berishës: të shohësh përtej pamjes dhe të zbulosh thelbin.

Ambasador i kulturës shqiptare

Fadil Berisha nuk është vetëm një fotograf – ai është një ambasador i kulturës shqiptare në botë. Në çdo intervistë, në çdo ekspozitë, dhe në çdo projekt, ai flet me pasion për rrënjët e tij. Ai ka fotografuar figura të njohura shqiptare, ka organizuar ekspozita që nderojnë trashëgiminë tonë kulturore, dhe ka mbështetur artistë të rinj shqiptarë që duan të ndjekin rrugën e artit.

Për të, të qenit shqiptar nuk është thjesht një identitet – është një burim frymëzimi. Ai ka sjellë në fotografitë e tij ngjyrat, simbolet, dhe emocionet e kulturës shqiptare, duke i prezantuar ato me krenari në skenën globale. Në këtë mënyrë, ai ka ndihmuar në formimin e një imazhi të ri për Shqipërinë dhe Kosovën – një imazh i bukurisë, talentit, dhe pasionit.

“Bukuria nuk është vetëm në pamje – është në shpirt, në histori, në dritën që njeriu mbart.”

Ky citat i Fadil Berishës është një pasqyrë e filozofisë së tij artistike. Ai beson se bukuria nuk është një standard i fiksuar, por një ndjesi që lind nga brenda. Për të, çdo njeri ka një histori që meriton të tregohet, dhe çdo fytyrë ka një dritë që meriton të ndriçohet. Ai nuk ndjek trendet – ai ndjek emocionin, autenticitetin, dhe dëshirën për të zbuluar të vërtetën.

Në botën e tij, fotografia është një akt dashurie – një përprjekje për të kuptuar, për të ndjerë, dhe për të ndarë bukurinë që na rrethon. Dhe në këtë përprjekje, Fadil Berisha ka arritur të bëhet jo vetëm një fotograf i madh, por edhe një rrëfimtari i shpirtit njerëzor.

Fadil Berisha është një nga emrat më të njohur në fotografi, jo vetëm për suksesin e tij profesional, por edhe për mënyrën se si ka përfaqësuar me krenari identitetin shqiptar në arenën ndërkombëtare. Si fotograf zyrtar i Miss Universe dhe Miss USA, ai ka qenë pas kamerës në disa nga momentet më ikonike të botës së modës dhe bukurisë. Portofoli i tij përfshin bashkëpunime me marka prestigjioze si Vogue, Harper’s Bazaar, Elle, dhe Cosmopolitan, si dhe me figura të njohura si Tyra Banks, Naomi Campbell, Zana Krasniqi, dhe Pia Wurtzbach.

Ai ka fotografuar aktorë të Hollywood-it, supermodele, këngëtarë të njohur, dhe personalitete televizive, duke sjellë një

Eleganca e një shqiptari në objektivin e botës



ndjeshmëri unike në çdo portret. Disa nga klientët e tij kanë qenë Cher, Jennifer Lopez, Beyoncé, Kim Kardashian, dhe Seal – emra që përfaqësojnë majat e industrisë së argëtimit. Ajo që i bashkon të gjithë këta yje është besimi që kanë pasur tek Fadili për të zbuluar anën e tyre më të vërtetë përmes objektivit të tij.

Në botën e modës, ai ka punuar me agjenci të mëdha si Elite dhe Ford Models, duke ndihmuar në formimin e karrierave të shumë modeleve të reja. Ai ka qenë pjesë e fushatave reklamuese për Estée Lauder, MAC Cosmetics, dhe Guess, duke sjellë një estetikë të rafinuar që kombinon luksin me ndjeshmërinë.

Por ajo që e bën Fadilin të veçantë nuk është vetëm fama – është mënyra se si ai ka ruajtur thjeshtësinë dhe përkushtimin ndaj artit të tij. Ai ka arritur të ndërtojë ura mes kulturave, duke sjellë një frymë shqiptare në çdo projekt ndërkombëtar. Për të, suksesi nuk është vetëm personal – është një mision për të treguar botës se çfarë mund të ofrojë një artist nga një vend i vogël me zemër të madhe.

Fadil Berisha ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm si mentor, promovues, dhe mbështetës i artistëve shqiptarë, duke i ndihmuar ata të depërtojnë në skenën ndërkombëtare. Ja disa mënyra konkrete se si ai ka kontribuar në rritjen e karrierave të tyre:

Mbështetje direkte për talentet e reja

Fotografi profesionale për artistët shqiptarë: Ai ka realizuar portrete dhe set-e fotografike për këngëtarë, modele, aktorë dhe figura publike shqiptare, duke u dhuruar atyre një prezantim vizual të nivelit ndërkombëtar. Ky ka qenë shpesh hapi i parë drejt një

karriere më të madhe.

Pa pagesë për të rinjtë me potencial: Në shumë raste, Fadili ka ofruar shërbimet e tij pa kompensim për artistë të rinj që nuk kishin mundësi financiare, por kishin talent dhe pasion të vërtetë.

Promovimi i figurave shqiptare në botë

Zana Krasniqi, një nga modelet shqiptare më të njohura, u bë pjesë e Miss Universe falë mbështetjes së Fadil Berishës, i cili jo vetëm e fotografoi, por edhe e udhëhoqi në përgatitje.

Ai ka ndihmuar në zgjedhjen dhe përgatitjen e përfaqësueseve shqiptare për konkurse bukurie si Miss Universe dhe Miss World, duke i trajnuar për prezantim, stil, dhe vetëbesim.

Mentorim dhe edukim artistik

Fadili shpesh ndan eksperiencën e tij në intervista, konferenca dhe ekspozita, ku flet për sfidat dhe mundësitë në industrinë e fotografisë dhe modës. Këto biseda janë burim frymëzimi për artistët e rinj.

Ai ka mbajtur workshope dhe masterclass-e, ku ndan teknikat e tij fotografike dhe filozofinë e tij artistike me të rinjtë që duan të ndjekin rrugën e artit.

Krenari dhe përfaqësim kulturor

Në çdo projekt, ai përpiqet të përfshijë elemente të kulturës shqiptare, duke i prezantuar ato me dinjitet dhe elegancë. Kjo ka ndihmuar në formimin e një imazhi pozitiv për artistët shqiptarë në botë.

Ai është një zë i fuqishëm për diasporën shqiptare, duke i inkurajuar të rinjtë që të mos harrojnë origjinën e tyre dhe ta përdorin atë si burim force dhe identiteti.

Forca ajrore kundër flakëve: Revolucioni i teknologjisë ushtarake

Në një verë të nxehtë, kur dielli digjet mbi male dhe era përhap flakët si një mallkim i padukshëm, shpresa shpesh vjen nga qielli. Zhurma e motorëve të fuqishëm që përshkojnë ajrin nuk është më paralajmërim lufte, por sinjal shpëtimi. Avionët ushtarakë, të ndërtuar për misione taktike dhe operacione të ndërlikuara, po transformohen gjithnjë e më shumë në mjete zjarrfikëse, duke u vënë në shërbim të mbrojtjes civile dhe natyrës. Në një botë ku zjarret pyjore po bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe më të rrezikshme, teknologjia ushtarake po tregon se mund të jetë një aleat i fuqishëm në luftën kundër katastrofave natyrore.

Zjarret pyjore janë intensifikuar ndjeshëm në dekadat e fundit, të nxitura nga ndryshimet klimatike, thatësitat e zgjatura dhe aktiviteti njerëzor. Vende si SHBA, Australia, Greqia, Spanja dhe Italia përballen çdo vit me dhjetëra mijëra hektarë të djegur, ndërsa flakët kërcënojnë jo vetëm natyrën, por edhe jetën e njerëzve dhe pasuritë kulturore. Në këtë kontekst, ndërhyrja ajrore është bërë një komponent thelbësor i strategjisë së menaxhimit të zjarreve. Avionët ushtarakë, falë kapacitetit të tyre të lartë, manovrimit në terrene të vështira dhe pajisjeve të avancuara, janë kthyer në mjete të pazëvendësueshme për shuarjen e flakëve.

Një nga avionët më të përdorur në këtë drejtim është C-130 “Hercules”, një gjigant i forcave ajrore amerikane, i cili mund të transportojë deri në 15,000 litra ujë ose lëndë retardante për të ngadalësuar përhapjen e zjarrit. Ky avion është pajisur me sistemin MAFFS (Modular Airborne Fire Fighting System), që lejon hedhjen e ujit me presion të lartë dhe saktësi të madhe. C-130 është përdorur me sukses jo vetëm në SHBA, por edhe në vende si Rumania, Spanja dhe Franca, ku ka ndihmuar në operacione të mëdha kundër zjarreve.

Një tjetër avion i rëndësishëm është “Canadair” CL-415, i njohur për aftësinë e tij për të marrë ujë direkt nga liqenet gjatë fluturimit. Ky avion amfib është veçanërisht i përshtatshëm për zona malore dhe bregdetare, dhe përdoret gjerësisht nga Kroacia, Greqia, Italia dhe Franca. Me një kapacitet prej rreth 6,000 litrash, ai mund të kryejë shumë hedhje në një ditë, duke ndihmuar në kontrollimin e flakëve në fazat kritike.

Në Europën Lindore, avionët C-27J “Spartan” janë përdorur gjithashtu për ndërhyrje në zjarre, veçanërisht në terrene të vështira ku manovrimi është i domosdoshëm. Rumania ka qenë një nga vendet që ka dërguar avionë të tillë në ndihmë të Shqipërisë gjatë krizës së zjarreve në vitet e fundit. Në gusht 2023, avionët rumunë kryen mbi 23 hedhje në zonat e Tomorit, Prespës dhe Oroshit, duke shpërndarë mbi 141,000 litra ujë dhe duke ndihmuar në shpëtimin e qindra hektarëve pyje.

Shqipëria, ndonëse nuk disponon flotë të specializuar zjarrfikëse ajrore, ka përfituar ndihmë nga vende të ndryshme përmes Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile. Suedia, Hungaria, Republika Çeke dhe Sllovakia kanë dërguar avionë dhe helikopterë për të ndihmuar në shuarjen e zjarreve, duke treguar se solidariteti ndërkombëtar është një armë po aq e fuqishme sa teknologjia. Në këtë kuadër, është diskutuar edhe ideja e krijimit të një flote të përbashkët zjarrfikëse për Ballkanin, që do të mundësonte ndërhyrje të shpejtë dhe efikase në rajon.

Përveç avionëve të mëdhenj, përdorimi i dronëve ushtarakë për vëzhgim dhe koordinim është një tjetër risi teknologjike. Dronët mund të identifikojnë vatra të fshehura, të ndihmojnë në planifikimin e hedhjeve ajrore dhe të monitorojnë përhapjen e flakëve në kohë reale. Kjo teknologji, e kombinuar me sistemet e navigimit të avancuar dhe radarët termikë, po e transformon mënyrën se si menaxhohen emergjencat natyrore.

Megjithatë, përdorimi i avionëve ushtarakë për qëllime civile nuk është pa sfida. Kostoja e mirëmbajtjes, nevoja për trajnim



të specializuar dhe koordinimi me forcat tokësore janë disa nga pengesat që duhen adresuar. Por përfitimet janë të mëdha: ndërhyrje të shpejta, akses në zona të paarrtshme dhe kapacitet i lartë për transportin e ujit dhe ndihmave.

Në fund të ditës, avionët ushtarakë që dikur fluturonin për të mbrojtur kufijtë, sot fluturojnë për të mbrojtur jetën. Ata nuk janë më thjesht simbole force, por mjete shpëtimi. Në një botë ku natyra po përballlet me sfida të paprecedent, teknologjia ushtarake po tregon se mund të vihet në shërbim të paqes, solidaritetit dhe mbrojtjes së përbashkët.

Sfidat kryesore të përdorimit të teknologjisë ushtarake në emergjenca civile

Kostoja e lartë e operimit dhe mirëmbajtjes

Avionët ushtarakë si C-130 “Hercules” apo “Beriev” Be-200, janë ndërtuar për misione strategjike dhe kanë nevojë për mirëmbajtje të specializuar, karburant të shtrenjtë dhe logjistikë të avancuar. Përdorimi i tyre për misione zjarrfikëse kërkon buxhet të konsiderueshëm, që shpesh tejkalon kapacitetin e institucioneve civile.

Nevoja për trajnim të specializuar

Pilotët ushtarakë janë të trajnuar për misione luftarake, jo për hedhje uji në lartësi të ulëta mbi zona të banuara. Ndërhyrja në zjarre kërkon manovrim preciz, koordinim me forcat tokësore dhe njohje të terrenit. Kjo kërkon trajnime shtesë dhe protokolle të veçanta për sigurinë e operacioneve.

Koordinimi ndërinstitutional

Integrimi i mjeteve ushtarake në operacione civile kërkon bashkëpunim të ngushtë mes Ministrisë së Mbrojtjes, Mbrojtjes Civile, Policisë dhe autoriteteve lokale. Mungesa e një strukture të qartë koordinimi mund të çojë në vonesa, keqkuptime dhe rrezik për personelin në terren.

Pavarësisht këtyre sfidave, përfitimet janë të mëdha dhe gjithnjë e më shumë vende po investojnë në teknologji të dyfishta – që mund të përdoren si për mbrojtje kombëtare, ashtu edhe për emergjenca civile. Zgjidhja qëndron në krijimin e strukturave fleksibile, trajnimin të përbashkët dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Redaksia e gazetës

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën “Ushtria” janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektivë, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Forcat e Armatosura – Rekrutimi 2025

🛡️ Ushtarë / ⚓ Detarë / ✈️ Ajrorë Aktivë

📅 20 tetor – 31 dhjetor 2025

Afati i dokumentacionit: 29 gusht 2025

i Info: <https://www.mod.gov.al/newsroom/njoftime/ushtar-detar-aktiv/7055-filluan-regjistrimet-e-kandidateve-per-ushtare-detare-aktive-ne-fa-per-periodhen-20-tetor-31-dhjetor-2025>

🎓 Akademia e FA – Kursi i Përgatitjes së Oficerit

👉 60 kuota studimi (9 muaj)

🏥 Mjekësi | ⚙️ Inxhinieri | 📡 Ndërlidhje | 🚚 Logjistikë | ✂️ Këmbësori & më shumë

📅 Afati aplikimit: 29 gusht 2025

i Info: <https://www.mod.gov.al/newsroom/njoftime/studente-brenda-jashte-vendit/7249-qpr-do-te-rekrutoje-kandidate-per-te-ndjekur-studimet-per-pergatitjen-e-oficerit-te-ri-ne-afa-per-vitin-akademik-2025-2026>

★ Shtoji Shqipërisë një Yll!

#ForcatEArmatosura #Rekrutim2025 #UniformaMeNder #OficerëTëRinj
#ShtojiShqipërisëNjëYll